

SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

Adhurojeni edhe më shumë Sportin!

Sigurohuni nga aksidentet gjatë aktiviteteve sportive dhe përfitoni mbulim të shpenzimeve mjekësore.

Blv. "Zogu I", Nr. 1, Tiranë, Tel: 04 2233 308 www.sigal.com.al
KOMPANIA MË E MADHE E SIGURIMEVE!

EKSPRES SPORT

Viti i 18^{te} i botimit
Nr. 41 (4287) E martë 14 shkurt 2012 Çmimi 30 lekë
(Në Greqi 1.5 euro)

Moti i keq, futboli ndalon për dy javë

Shtyhen të gjithë kampionatet dhe Kupa e Shqipërisë. Rifillimi pas miqësore së Kombëtares në Gjeorgji

Lala, sherr te Hanoveri

I thotë "mbylle gojën", zëvendëstrajnerit. Më pas, kërkon falje me humor: "M'u dogjën siguresat"...



Zëvendëstrajneri i jep dy minuta pezullim Lalës, për ndërhyrje të qëllimshme ndaj një shoku



Lala sapo ka ofenduar zëvendëstrajnerin. Trajneri Slomka e dërgon para kohe në dushe



Lala, i nervozuar hedh jelekun e stërvitjes

Çernomorets do Bakajn, Dinamo Bukuresht e jep borxh vetëm në Rumani

22-vjeçari në pritje të pasaportës: Krenar të vishem kuqezi!

De Biazi i heq nr.1 Ujkanit, merr një Berishë për portën



Është Etrit Berisha, gjiganti 194 cm i Kalmarit, kampion i Suedisë dhe titullar i Kombëtares së Kosovës



Kuqeblutë në një moment delikat edhe për stolin

Vilaznia e do... "anglez"



Starova e Duro në "pole". Tekniku që do të marrë ekipin, sezonin e ardhshëm, do ketë buxhetin e garantuar që në qershor dhe do të zgjedhë lojtarët që dëshiron. Objektivi do të jetë një trofe

Në kushte ideale nuk do ishte shumë normale që, në një skuadër e cila ende nuk ka dalë nga objektivat, të flitej për trajnerin pasardhës. Por meqenëse tani palët kanë dalë pothuajse hapur dhe, si kryesia e klubit ashtu dhe Vata kanë pranuar qoftë dhe me gjysmë zëri që kontrata që mbaron në maj me siguri nuk do të rinovohet, drejtuesit kanë filluar të mendojnë sigurisht për Vilazninë e së ardhmes, atë të sezonit të ri. Me siguri, qindra mijëra euro të harxhuara dhe të menaxhuara keq në vitin e parë të shoqërisë së re aksionere duhet të kenë shërbyer si një ... (faqe 5)



Tirana, kampione që në 1911-n?

Shtypi i kohës zbulon se në atë vit në Fier është organizuar një turne me 8 skuadra. Ka fituar Tirana, me kapiten Zyber Hallullin (faqe 7)

Atmosferë Pero Pejiç si... Ibra, te Flamurtari besojnë!

Në Vlorë janë të bindur: Shtatë pikët e diferencës, në fund mund të jenë 0

Flet Shkëmbi "Ruajmë këtë ritëm, jemi sërish për trofe!"

Kapiteni i Skënderbeut: E kemi thënë: është radha e të tjerëve për të gabuar

Champions League/ Starton sot faza e 1/8-ve

Rinis ëndrra "Allianz Arena" 15 skuadra kanë një synim: Të pengojnë Barcelonën!



Katalanasit, nëse do ta fitonin për të dytën herë radhazi, do të vendosnin rekordin absolut, kurrë i arritur që prej 1993, kur ndryshoi formati i Kupës së Kampionëve

Sot, Leverkusen-Barcelona Guardiola: S'duhet të nënvlerësojmë, mund të fitojmë sërish ne!

Nesër, Milan-Arsenal Ibrahimoviç-Henri, takohen "dezertorët" e... "Camp Nou"-t!

Kilikosje



Në Berat, pas 2-4 me Skënderbeun thanë: "Tomori humbi, por fitoi standardet". Këtej nga Tirana, pyesin: Mos ka patur gjë zgjedhje atje?

Duhet 6 gola, fierakët marrin pikë shprese

Dje, Dinamo - Apolonia 3-3

TAÇI OIL INTERNATIONAL

Albanian Refining & Marketing of Oil

ARMO

Burim i një energjie të pastër

Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Sky Tower 4/2 Tiranë - Albania
Tel: +355 4 2421645 Fax: +355 4 2421484 Fax: +355 4 2421061
www.taci-oil.com www.armorefinery.com

Dinamo e Bukureshtit dhe Elis Bakaj kanë rënë dakord që futbollisti i përfaqësueses shqiptare të jepet borxh, gjashtë muajt e ardhshëm. Trajneri i kryesuesve të kampionatit rumun, Ciobotaru, nuk e sheh si titullar në skuadrën e tij, sidomos tani pas blerjes së mesfushorit të krahut të majtë, Curtean, dhe për këtë arsye dy palët vendosën që të ndaheshin për të paktën 6 muaj. Gjithçka u vendos në një takim mes trajnerit Ciobotary dhe vetë lojtarit të përfaqësueses së Shqipërisë. Sipas "prospertor" që e botoi ekskluzivisht këtë lajm, shqiptari

nuk mori garanci nga trajneri i tij për të luajtur më shumë se në fazën e parë, ku grumbulloi vetëm 239 minuta lojë. Ndërkohë që mediat e tjera thonë vetëm që Bakaj është pjesë e "listës së zezë" së trajnerit prej pesë futbollistësh.

Ofertat- Futbollisti ka një ofertë "të majme" nga Chernomorets Odesa në Ukrainë (skuadra e Kristi Vangjelit), por rumunët dëshirojnë që shqiptari të luajë në kampionatin vendas. Tri skuadra të Superligës Rumune, sipas raporteve të mediave kanë shprehur interesim për mesfushorin e përfaqësueses shqiptare. Ato janë

Çernomorets do Bakajn, Dinamo Bukuresht e jep borxh vetëm në Rumani!

Klubi dhe lojtari kanë rënë dakord për largimin e përkohshëm. Ukrainasit e kanë kërkuar zyrtarisht por rumunët e japin vetëm në kampionatin vendas. Astra Ploieshti, FC Brashov dhe Panduri, destinacioni i mundshëm. Vetë Bakaj: "Largohem, por tifozët janë kundër..."

Astra Ploieshti, FC Brashov dhe Panduri. Të treja marrin pjesë në Ligën e Parë të vendit në fjalë dhe janë skuadra të mesit të tabelës. Vetë lojtari do të

preferonte të shkonte te Çernomorets në Ukrainë, një klub që financiarisht është shumë më e pasur se klubet rumune. Kristi Vangjeli, që firmosi gushtin

e kaluar për këtë klub, do të marrë një rrogë prej rreth 1 milionë eurosh për tre vite. Sidoqoftë, gjasat që Bakaj të kalojë te Chernomorets janë të pakta, duke qenë se synimi i klubit është "të monitorohet Bakaj deri në fund të sezonit në një klub rumun, për të vendosur më pas se çfarë do të bëhet me kartonin e tij".

Ndërkohë, siç kishte informuar ekskluzivisht "Sport Ekspres" disa javë më parë, mediat rumune kanë konfirmuar se Dinamo e Bukureshtit ka refuzuar një ofertë të klubit izraelit, Makabi Netanja. Kjo ofertë ishte "e majme" ekonomikisht, por klubi vuri veton.

Bakaj-Vetë futbollisti ka pranuar mbrëmë vonë se mund të largohet nga Dinamo e Bukureshtit. "Po, ka shumë mundësi që të largohem deri me datë 24 shkurt, pasi dëshiroj të luaj më shumë se në fazën e parë. Vështirë të largohem jashtë vendit, pasi periodha e federimeve ka përfunduar, kemi disa oferta në Rumani që po i shqyrtoj. Më bëhet qejfi për faktin që tifozët janë kundër këtij transferimi, shpresoj ta fitoj këtë bast dhe të rikthehem kryelartë te Dinamo e Bukureshtit", tha mbrëmë lojtari.

ALTIN SHORDI

Lala, sherr në stërvitjen e Hanoverit!

I thotë "mbylle gojën", zëvendëstrajnerit. Më pas kërkon falje me humor: "M'u dogjën sigurecat"... Nuk ishte sjellja që pritej prej meje"

Ana e tij më e fortë është dyluftimi. Këtë thotë mesfushori i Hanoverit, Altin Lala, për veten e tij. Ylli shqiptar e tregoi dje edhe në stërvitje, por duke "sulmuar" dhe më pas debatuar ashpër me zëvendëstrajnerin e tij, Norbert Dyvel (44 vjeç). Ngjarja ndodhi gjatë stërvitjes së ditës së hënë, pas një faulli të shkaktuar nga mbrojtësi 20-vjeçar, Kristofer Avevor. Lala donte të merrte hak, duke i shkaktuar dy herë faull ndaj shokut të tij të skuadrës, derisa reagoi zëvendëstrajneri Norbert Dyvel. Për të qetësuar "gjakrat" dhe zbutur situatën, asistenti i trajnerit, Mirko Slomka i vendosi një

Precedenti Thonjtë në grykë holandezit

Në fakt, është hera e dytë që Altin Lala humb kontrollin dhe përfshihet në një incident që nga janari. Së fundi, kishte ndodhur gjatë fazës përgatitore në Portugali, gjatë një ndeshje miqësore midis Hanoverit dhe skuadrës dhe holandezëve të Herenit, kur i hodhi thonjtë në grykë holandezit 27-vjeçar, Gerald Sibon, pasi ky i fundit ndërhyri shumë keq ndaj shqiptarit.

"gjobë" kohore prej dy minutash Lalës, për ta ndërprerë stërvitjen dhe ftohur nervat. Pikërisht, në këtë moment Lala humbi komplet kontrollin e nervave, duke iu sulur ndihmëstrajnerit: "Qepe gojën! Unë nuk të bindem ty!". Lajmi bëri bujë në mediat gjermane, dhe tabloidi popullore "Bild" e shoqëroi artikullin edhe me disa foto, si dhe me një speciale nga rastet e grindjeve të lojtarëve të tjerë gjatë viteve. Kjo ngjarje solli edhe përfundimin e stërvitjes së Lalës me Hanoverin. Trajneri Mirko Slomka (44 vjeç) e dërgoi ish-kapitenin e Shqipërisë drejt dushëve për t'u relax-

suar dhe reflektuar. Në fakt, Lala dallohet për temperamentin e tij, madje në Gjermani ai ka nofken "Kampzverg", apo shqip "Xhuxh luftarak", pasi i kërkon shpesh dyluftimet, madje një prej tyre, ajo kundër yllit të Bajernit, Frenk Riberi, bëri bujë në mediat ndërkombëtare, kjo dhe për shkak të staturës së lojtarit të Kombëtares Franceze dhe një prej dhjetë lojtarëve më të shtrenjtë në Botë. "Bild" thekson se vendimi i Slomkës për të dërguar Lalën të qetësohet nën ujë e ngrohtë të dushit, nuk do të ndikojë aspak në karrierën e shqiptarit, pasi 36-vjeçari është në përfundim të kontratës në fund të sezonit. Në fakt, Lala është një idhull në skuadrën e tij. Është një kult. Kjo edhe për shkak se ai është lojtari më i vjetër në skuadër, jo vetëm përsa i përket moshës, madje është lojtari më i vjetër i Bundesligës, por dhe se është më besniku i klubit, pasi ka veshur këpucët e futbollit për Hanoverin, qysh nga viti 1998, duke mbajtur fanelën e klubit gjerman për 14 vjet. Gjithsesi, Lala reagoi pozitivisht pas stërvitjes, duke kërkuar falje: "Më vjen keq, por m'u dogjën sigurecat"! Natyrisht, reagimi im ishte pak i shpejtuar. Për këtë u kërkoja falje si trajnerit (Slomka) ashtu dhe Norbert Dyvel. Nuk ishte një shembull i mirë. Më vjen keq. Nuk do t'ia lejoj më vetes të më ndodhin gjëra të tilla".



Zëvendëstrajneri i jep dy minuta pezullim Lalës, për ndërhyrje të qëllimshme ndaj një shoku



Lala sapo ka ofenduar zëvendëstrajnerin. Trajneri Slomka e dërgon para kohe në dushë



Lala, i nervozuar hedh jelekun e stërvitjes

Botues
"Sport Ekspres"
Sh.p.k.

Kryeredaktor:
Zv/kryeredaktor:
Redaktor online:

FATMIR MËNERI
GJERGJI STEFA
KLEVIS GJONI

Sektori i brendshëm:
ALTIN SHORDI
DRITAN IKONOMI
SAIMIR DEMI
GJERGJ VYSHKA
ARBI LAÇI

Sektori i jashtëm:
GJERGJ CICANI
VASIL BAKËLLBASHI
ANTON CICANI
KLODIAN SADE
BLENDAR KUKA

RAIFFEISEN BANK
Dega Nr 1, TIRANË
Nr. i Llogarisë: 4037 / 3621

ADRESA E REDAKSISË:
Rr. "Fadil Rada", Nr. 102
(pranë Agjencisë Telegrafike Shqiptare)

Tel&Fax: 00 355 4 235591 Adresa në Internet: www.sportekspres.com
Kontakt: redaksiaspek@hotmail.com



Ujkani në krah të Kristiano Ronaldos: "Ylli i fundjavës"

Portieri shqiptar është vendosur mes tetë protagonistëve të fundjavës në futbollin botëror

Portieri shqiptar i Novarës në Serinë A, Samir Ujkani, u përfshi në një listë të përzgjedhur nga portali sportiv në internet, "Goal.com", midis tetë protagonistëve me të mëdhenj të fundjavës, një klasifikim ky i hartuar çdo javë nga ekspertët e uebsajtit të mirënjohur. Ujkani bëri një paraqitje madhështore në fitoren 1-0 të Novarës ndaj Interit në "San Siro", duke qenë lojtari-kyç në triumfin e skuadrës së tij ndaj ish-kampionëve të Italisë dhe Europës. Ja si e përshkruan "Goal.com" përfshirjen e portierit të Kombëtares Shqiptare: "Samir Ujkani-Novara: Novara shokoi Interin, në atë fitore 1-0 në "San Siro" në Serinë A, ditën e diel, dhe Samir Ujkani ishte një figurë kyçe në atë triumf. Zikaltërit i ushtruan një presion të madh mbrojtjes së Novarës, por portieri shqiptar ua zhvlerësoi të gjitha përpjekjet, duke bërë një pritje të klasit botëror në atë gjuajtje të Xhampaolo Pacinit në kohën shtesë". Në listën e protagonistëve janë disa nga emrat më të mëdhenj të futbollit European dhe Botëror, si Kristiano Ronaldo i Realit të Madridit (autori i një triplete kundër Levantes dhe shënoi golin me numër 4000 të Realit në "shtëpi"); Uejni Runi i Mançester Juanitidit (dygolësh); Emanuel Adebajori i Totenhemit (dha katër asistë dhe shënoi një gol); Raul Garsia i Osasunës, lojtarit-kyç në fitoren 3-2 ndaj Barcelonës (një asist dhe një gol); Shahri Ishaki i Lions XII të Singaporit (3 gola); Xhon Guideti i Fejenordit (tre gola në tri ndeshje rresht në ndeshjet në shtëpi); Shinji Kagaua i Borussia Dortmundit (dy gola në dy ndeshje e fundit). Lojtari më i mirë i botës i javës së 143-të u shpall portieri i Kombëtares së Zambias, Kenedi Muine, i cili priti penalltinë e Didie Drobasë në finalen e Kupës së Kombeve të Afrikës, Zambia-Bregu i Fildishtë (8-7 me penallti).

Kombëtarja, grumbullimi në Gjeorgji!

Përfaqësuesja Shqiptare nuk do të grumbullohet në Shqipëri, për ndeshjen miqësore kundër Gjeorgjisë. Skuadra kuqezi do të grumbullohet në Tbilisi, me datë 26 shkurt, dhe do të zhvillojë tre ditë stërvitje përpara takimit, që do të luhet në kryeqytetin e këtij vendi. Takimi do të përbëjë debutimin e Xhani De Biazit në krye të përfaqësueses.

Ngushëllim

"Sport Ekspres" i bashkohet trajnerit të Shpresës, Skënder Gega në hidhërimin për humbjen e nënës së tij.

Trajneri italian është i shqetësuar nga gabimet e numrit "1" të Novarës në ndeshjet e fundit me përfaqësuesen. Gati pasaporta për Etrit Berishën, gjigantin 194 cm të Kalmarit, kampionit të Suedisë dhe titullar i Kombëtares së Kosovës

Altin SHORDI

Xhani De Biazi do ta shpërblejë paraqitjen madhështore të Samir Ujkanit në ndeshjen Inter-Novara me... zbritjen e një vendi në hierarkinë e portës së Shqipërisë. Burime të sigurta, por konfidenciale në FSHF, i thanë dje "Sport Ekspresit", se trajneri italian ka marrë vendim që t'i besojë numrin 1 të portës së Shqipërisë, portierit të Kalmarit në kampionatin suedez, Etrit Berishës, 22 vjeç. Futbollisti në fjalë është titullar i Kalmarit në Suedi, kampion gjatë sezonit të kaluar. Ai është 1.94 cm i gjatë dhe sipas specialistëve, ai ka një zhdërvjelltësi jashtë normale për këtë lartësi dhe 90 kg e tij. "Trajneri i përfaqësueses është pezmatuar me paraqitjet e portierit titullar, Samir Ujkani, në ndeshjet e fundit me Kombëtaren. Ai ka parë videot e të gjitha ndeshjeve të tij me kuqezinjtë dhe ka konstatuar se nuk është në lartësinë e detyrës, ndryshe nga paraqitjet e mira që ka bërë me Novarën. Lojtari do të kalojë për momentin në plan në dytë. Por Ujkani megjithatë do të ketë mundësinë që të luftojë për vendin e titullarit në të ardhmen. Trajneri ka si synim të krijojë një konkurrencë të rëndësishme për portën e Shqipërisë", tha burimi i gazetës. Tekniku kuqezi, De Biazi, nuk ka kërkuar mes portierëve në organikën kuqezi, si zëvendësues të mundshëm të Ujkanit. Ai ka gjetur një emër të ri. "Trajneri dhe stafi i tij kanë hulumtuar në internet. Ata kanë pikasur Etrit Berishën, portier të Kalmarit, si njeriun më të përshtatshëm nga numrat 1 që mund të luajnë për Shqipërinë. Stafi i tij dhe personat përgjegjës në FSHF e kanë ndjekur futbollistin dhe kanë biseduar me të. Ata kanë konstatuar dëshirën e futbollistit dhe më pas kanë autorizuar



Etrit Berisha, kandidati për numrin 1 të Kombëtares

De Biazi i heq numrin 1 Ujkanit, merr një Berishë nga Suedia!

Flet portieri Berisha: "Krenari të vishem kuqezi!"

Portieri 22-vjeçar i Kalmarit: "Më kërkon edhe Suedia, por unë jam 100% shqiptar"

Portieri i Kalmarit në Suedi, Etrit Berisha, konfirmoi dje që është në bisedime me FSHF-në për t'u pajisur me pasaportë shqiptare me synim mbrojtjen e portës së Shqipërisë. "Po, kam pasur kontakte me zyrtarët e FSHF-së. Dhe ata më kanë njoftuar se dëshirojnë të më kenë në Kombëtare. Tani jemi në bisedime dhe të shohim se ç'do të ndodhë në të ardhmen. Nuk do të nxitohem pasi dëshiroj të bisedoj shtruar me familjen dhe zyrtarët e Federatës së Kosovës", tha mbrëmë lojtari për gazetën kosovare "Koha Ditore". Berisha mbron ngjyrat e përfaqësueses së Kosovës. Ai shtoi megjithatë, se: "Është nder i madh që kërkohej nga FSHF dhe është nder edhe më i madh që të mbrojmë ngjyrat e kombëtares kuqezi. Aktualisht jam i dëmtuar dhe kjo më jep kohë që të mos nxitohem me vendimin", tha ai. Berisha konfirmoi se Shqipëria nuk është përfaqësuesja e vetme që e kërkon. "Gjatë këtyre ditëve kam pasur një interesim edhe nga trajneri i portierëve të Suedisë, por Shqipëria natyrshëm që ka përparësi në këtë rast. Ndjehem 100% shqiptar", tha lojtari.



Kush është Etrit Berisha?

Etrit Berisha, portieri i pikasur për rolin e "numrit 1" në përfaqësuese, ka lindur më 10 mars të vitit 1989. Ai e nisi futbollin në Kosovë, në klubin "2 Korriku", kur në vitin 2008, vetëm 19 vjeç, kaloi te Kalmarit në Suedi. Portieri, fillimisht luajti si rezervë te klubi në fjalë, por në vitin 2010, vetëm 20 vjeç u bë titullar i padiskutueshëm dhe që atëherë nuk ka luajtur, vetëm në raste dëmtimesh. Ai vlerësohet si i sigurt në dalje, diçka që i ka munguar Ujkanit në përfaqësuese, si dhe një fenomen në përballjet vetëm-për-vetëm me sulmuesit kundërshtarë. Ai ka një "nam" të mirë edhe në pritjet e penalltive.

FSHF-në që të hyjë në bisedime zyrtare. Atij i është bërë oferta për t'u pajisur me pasaportë shqiptare. Lojtari ka dhënë gatishmërinë e tij", vazhdoi burimi i gazetës "Sport Ekspres".

Vetë trajneri De Biazi nxitohet ta ketë lojtarin sa më parë në skuadër, në mënyrë që të familjarizohet me ekipin dhe të jetë i gatshëm për ndeshjen e parë eliminator. Megjithatë, lojtari ka një dëmtim në shputën e dorës dhe ai do të jetë plotësisht i gatshëm, vetëm pas dy javësh, kohë kur nis grumbullimi kuqezi. Njëkohësisht ai duhet të jetë i pajisur me pasaportën shqiptare, diçka që FSHF synon ta arrijë në kohë për këtë miqësore. "De Biazi synon ta ketë që me datë 26 shkurt, në grumbullimin për Gjeorgjinë, nëse kjo nuk do të bëhet, do të ndodhë në ndeshjen e radhës miqësore, që me shumë mundësi do të zhvillohet në muajin maj", mbylli burimi i gazetës. Ujkani, u bë titullar në përfaqësuese rreth dy vjet më parë, pas një dëmtimi të gjatë të Beqajt, që u pasua me braktisjen nga ky i fundit i futbollit të luajtur. Berisha do të ishte portieri i tretë kosovar radhazi që bëhet titullar i përfaqësueses. Në mes tyre, për një periudhë të shkurtër numrin 1 e kanë mbajtur Ilion Lika dhe Isli Hidi.

Moti i keq, futbolla ndalon 2 javë

Mëkat, sepse rikthimi tregoi se mund të shihnim ndeshje gjithnjë e më të forta. Një apel për klubet, që ta trajtojnë me kujdes infrastrukturën

Në dy javët e ardhshme nuk do të luhet futboll në asnjë fushë të Shqipërisë. Federata Shqiptare e Futbollit e ka marrë dje këtë vendim duke parë se moti gjithnjë më i rënduar po sillte probleme fushave dhe se pothuajse të gjitha skuadrat dhe stafet teknike ishin duke u ankuar në lidhje me gjendjen e terreneve. Në fakt, ka njëfarë keqardhje sepse rik-

thimi i futbollit të luajtur kish filluar mirë dhe me emocione duke prodhuar ndeshje të bukura dhe shumë emocione. Ndërkohë që të gjithë prisnin të shikonin ndeshjet e tretë në grupe sidomos javën e ardhshme në kampionat, ku do të kishim dy përballë të forta si Flamurtari-Teuta e Tirana-Kastrioti, tanimë duhet të presim dhe dy javë me shpresë se kushtet

atmosferike do ta ofrojnë një mundësi të tillë.

Pavarësisht se vendimi është marrë me konsultën e klubeve, këto të fundit duhet të tregohen gjithnjë e më shumë të përgjegjshme në trajtimin e infrastrukturës dhe sidomos në mirëmbajtjet e fushave të futbollit, kusht i domsdoshëm për zhvillimin e ndeshjeve normale.

Një skuadër e rëndësishme është në rritje e sipër

Tri ndeshje të mëdha brenda dhe Pejiç si Ibra, Flamurtari beson

Në Vlorë janë të bindur, shtatë pikët me vendin e parë mund të jenë zero deri në fund të kampionatit. Për këtë duhet një fazë e dytë ëndrrash. Ironia kuqezi: “Kur e bëri Skënderbeu një vit më parë...”

Shatë pikë larg vendit të parë me 12 javë të mbetura për t'u luajtur dhe me tre skuadra për t'u recuperuar, do të ishin një motiv i qartë për këdo për të mos thënë fjalën “titull”. Por jo për Flamurtarin, e sidomos jo për Flamurtarin e 2012-ës. Kjo skuadër ka treguar rritje në lojë dhe në emra dhe tanimë nëse ka pak fat shpreson që në javët e fundit, të jetë edhe



Pero Pejiç

ajo në “lojë” për titull. Arsyet? Dy, mbi të gjitha.

Ndeshjet—me kundërshtarët direktë Flamurtari do t'i luajë në fushën e saj. Teuta e vendit të parë, Tirana dhe Skënderbeu, do të kalojnë nga Vlora në këtë fazë të dytë. Trajneri Muça dhe stafi teknik e di fort mirë se me 9 pikë të plota në këto 3 ndeshje, llogaritë bëhen ndryshe. Por një zyrtar i stafit, tha se: “Çdo ndeshje është njësoj, duhet të luajmë çdo takim si finale nëse duam vendin e parë. Sigurisht që është gjë e mirë që ndeshjet e rëndësishme i luajmë në stadiumin tonë”. Kanë filluar të besojnë.

Pejiç—Nëse ka një blerje të zgjuar, meritë për të cilën ka dhe trajneri Muça, gjatë janarit për të gjitha skuadrat është Pero Pejiç. Një lojtar tip-“Ibra” për Flamurtarin, shënon dhe pason, tërheq skuadrën dhe krijon një repart më vete në

sulm. Me siguri fitorja në Kamëz nuk do kish ardhur nëse Pero nuk do kish vënë diktatin në pjesën e dytë e nuk do kish treguar supremaci në fushën e lojës.

Lena—Mungesa e Lenës është ndjerë konsiderueshëm në këto ndeshje të para të vitit, megjithatë vlonjatët janë të bindur që me rikthimin e tij skuadra do të funksionojë dhe më mirë se ç'po bën. “Normalisht ai është numri 10 që kemi ne,— thotë një zyrtar,— dhe loja kalon nëpërmjet këmbëve të tij”. Një forcë më shumë.

Ironia—Shtatë pikë janë shumë? Kush tha? Në Vlorë e kanë gati përgjigjen: “Pyesni njëherë Skënderbeun si ia doli vjet? Ne nuk do fitojmë si ata, por ka patur raste që ka ndodhur”. Për të qenë serioz, që të ndodhë, duhet mundur Teuta pas dy javësh. Kren më pas do të ishte -4. Kush nuk do të besojë më?!

MOISI DALIPI



Shkëlqim Muça

Edhe pse trajneri Muça nuk e ka fshehur gëzimin që ka ndjerë nga fitorja që ka arritur skuadra e tij në ndeshjen me Kamzën, përsëri është treguar i kursyer në vlerësimet që ai bën për lojën e zhvilluar nga futbollistët e tij. “As që bëhet fjalë se kjo fitore ka ardhur në një moment shumë të kërkuar nga skuadra jonë, por kjo nuk do të thotë se jemi në maksimumin tonë. Përveç mungesave që kanë ndikuar këtu, unë mendoj se kemi ende nevojë për t'u kompaktësuar edhe më shumë në lojën tonë kolektive. Ardhjet e reja nga merkato kanë qenë pak të vonuara, ndaj duhet

edhe pak kohë për të parë në fushën e lojës atë Flamurtar që unë kërkoj”. Më pas, trajneri ka shtuar: “Kuptohet që në këtë kuadër do të shfrytëzohet në maksimum këto ditë, për të bërë më të mirën tonë në drejtim të reflektimit të kërkuar”.

Ndeshja e javës së kaluar me Kamzën ka qenë ndeshja e parë që sulmuesi Selimi e ka filluar si titullar me fanelën e Flamurtarit. Edhe pse duhet pranuar se ky sulmues 27-vjeçar me golin e shënuar ka ndihmuar jo pak skuadrën të marrë tre pikë me shumë vlerë, përsëri mendon se gjithçka nuk përfundon deri këtu. “Më

Selimi dhe Koliqi duan më shumë nga vetja, Muça nga skuadra

Lojtarët e rinj flasin pas ndeshjes me Kamzën: “Nuk bëmë më të mirën tonë”. Trajneri i Flamurtarit: “Të gjithë kanë vend për t'u rritur edhe më”

vjen mirë që në ndeshjen e parë si titullar gjeta atë gol që fitoi skuadra. Por kjo nuk është gjithçka për mua. Unë premtoj të shënoj edhe gola të tjerë për Flamurtarin. Përpara kemi për të zhvilluar ndeshje të rëndësishme, ndaj do të më duhet të rritem në shumë në formën time sportive. Me sa po kuptoj, në skuadër ka vend vetëm për lojtarë që kanë formë të mirë”. Shumë pak kishin menduar se trajneri Muça do të guxonte t'i besonte në këtë periudhë detyrën e titullarit të portës, portierit Enea Koliqi që kishte vetëm pak ditë që ishte bashkuar me skuadrën. Ndoshta kjo ka

ndikuar edhe në emocionet që ka përjetuar gjatë pjesës së parë për të ardhur në ndryshimin e duhur në të dytën. “Ka qenë ndeshja ime e parë në kampionatin shqiptar dhe natyrshëm që kam pasur dhe emocione. Jam ndjerë më ndryshe në pjesën e dytë. Fitorja që ka marrë skuadra në këtë ndeshje më ka ndihmuar shumë të ndihem më i motivuar për t'u përshtatur dhe më shpejt me skuadrën time të re, Flamurtarin. Besoj shumë në vetvete se në ndeshjet e ardhshme do të jem më i lirshëm dhe shumë më në formë, ashtu siç e kërkon skuadra”.

M.D.

Niazi Lena drejt riaftësimit të plotë

Dëmtimi i pësuar nga mesfushori Niazi Lena duket se ka filluar të lihet pas dhe gjithçka për riaftësimin e tij të vihet në rrugën e duhur. Që nga fillimi i javës së kaluar, pas dy javëve pushim, Lena ka dalë në stërvitje të diferencuar dhe nga stafi mjekësor që po ndjek ndryshimin po konstatohet se riaftësimi është në rrugën e duhur. Duke kërkuar të shfrytëzohen për këtë qëllim dhe këto ditë të shtyrjes së ndeshjeve për kampionat dhe Kupë është menduar që java e ardhshme do sjellë dhe riaftësimin e plotë të mesfushorit Lena të dëmtuar katër javë më parë në kavalje.

Vonesa e Amburesë shqetëson vlonjatët

Në ditët e fundit të javës së kaluar drejtuesit e klubit të Flamurtarit kanë pritur të afrohej tek skuadra e tyre, mbrojtësi nga Gaboni, Ambure. Pjesëmarrja me ekipin kombëtar të vendit të tij në Kupën e Afrikës ka qenë një nga arsyt e vonesës. Por kur disa afate janë shkelur, dje është mësuar se vonesa e tij për të ardhur në Vlorë duket se janë marrëdhëniet e tij me klubin e vet, për të siguruar udhëtimin drejt vendit tonë. Drejtuesit vlonjatë janë shprehur se në ditët e ardhshme do të ketë dhe një prononcim zyrtar të tyre për “çështjen Ambure”.

Ngushëllim

Redaksia e gazetës “Sport Ekspres” i shpreh ngushëllimet më të sinqerta dhe i qëndron pranë gazetarit sportiv, Elvis Rexha, për humbjen e njeriut të dashur, babait të tij.

Kuqeblutë po kalojnë një moment negativ

Vllaznia del hapur: Duam trajner në "stilin anglez"!

Tekniku që do të marrë ekipin, sezonin e ardhshëm, do ketë buxhetin e garantuar që në qershor dhe do të zgjedhë lojtarët që dëshiron. Objektivi do të jetë një trofe. Duro dhe Starova në "pole-position"

Në kushte ideale nuk do ishte shumë normale që, në një skuadër e cila ende nuk ka dalë nga objektivat, të flitej për trajnerin pasardhës. Por meqenëse tani palët kanë dalë pothuajse hapur dhe si kryesia e klubit ashtu dhe Vata kanë pranuar qoftë dhe me gjysmë zëri që kon-

trata që mbaron në maj me siguri nuk do të rinovohet, drejtuesit kanë filluar të mendojnë sigurisht për Vllazninë e së ardhmes, atë të sezonit të ri. Me siguri qindra mijëra euro të harxhuara dhe të menaxhuara keq në vitin e parë të shoqërisë së re aksionere duhet të kenë shërbyer si një

mësim i mirë që të mos bëhen më të njëjtat gabime në të ardhmen. **Vata**-Drejtuesit, pavarësisht ndonjë qejfmbetje në drejtim, janë treguar profesionistë dhe në publik nuk kanë lëshuar asnjëherë akuza direkte për Vatën. Ata në përgjithësi ia kanë plotësuar dë-

shirat e merkatos dhe e kanë trajtuar profesionalisht mirë. Drejtuesit mund të jenë të pakënaqur por kanë kuptuar që tani ndërrimi i trajnerëve do të kishite vetëm kosto financiare dhe aspak rezultate sportive. Vllaznia është në një pozicion ku nuk pretendon më asgjë në kampionat,

vetëm mos qoftë e thënë të rrezikojë plejautin ndërkohë që në Kupë nëse mundet nga Flamurtari në Shkodër praktikisht është e eliminuar. Në këto kushte të investosh në një trajner të ri, është pa sens. Pastaj, kush e merr Vllazninë në këtë momente ku sërish dështimet në rezultate

mund të vazhdojnë?! **E ardhmja**-Drejtuesit kanë një gjë të qartë në kokën e tyre, ata nuk duan më të besojnë në atë që Vata e konsideron një "projekt". Me shumë diplomaci, do ta falënderojnë teknikun për punën e bërë dhe ndërkohë janë duke studiuar me kujdes pistat për ndonjë trajner të mundshëm. Duke qenë se dëshirojnë një sezon të ri fitues ata do të përpiqen të hyjnë në bisedime me trajnerë të sprovuar në vend. Që tani ata janë duke menduar që t'i bëjnë një ofertë Duros dhe Starovës, dy trajnerë me të cilët kanë pasur kontakte edhe pas shkarkimit të Josës, përpara se të vinte Vata. Asokohe në kampionat e sipër, të dy trajnerët e refuzuan Vllazninë, por tani janë gati ta marrin atë me një projekt fillestar serioz. Drejtuesit kërkojnë që trajneri i ri të mendojë vetë për merkaton me synimin për të ndërtuar një skuadër serioze të aftë për të pretenduar. Ata do t'i lënë në dispozicion trajnerit, buxhetin me direktivën e vetme: që lojtarët ndoshta të jenë nga tregu shqiptar dhe jo i huaj.

ANTON ZALLI



Shpëtim Duro

2

trajnerë

ka Vllaznia këtë sezon. Josa është larguar për mungesë rezultatesh, ndërkohë që, megjithëse rezultatet i kanë munguar dhe Vatës, ai do të vijojë punën deri në fund të kontratës



Sulejman Starova

"Heshtje shtypi pa afat", ky është vendimi që kanë marrë drejtuesit e skuadrës së Vllaznisë, ditën e djeshme, për të gjitha hallkat e skuadrës. Kategorikisht, kuqeblutë kanë ndaluar prononcimet për mediat për të gjithë lojtarët, stafin teknik dhe atë drejtues. "Duke filluar nga dita e somte (dje-shme), Vllaznia hyn në "heshtje shtypi"

"Heshtje shtypi" për të gjithë!

Kryesia e klubit, ka vendosur: "Askush nuk ka të drejtë të flasë për mediat derisa ne të vendosim të kundërtën, madje as stafi teknik"

tje shtypi pa afat". Ky vendim merret në shërbim të përqendrimit më të madh të skuadrës në prag të sfidave të rëndësishme qoftë për Superligën

apo dhe Kupën e Shqipërisë", thuhet në prononcimin zyrtar që ka bërë Vllaznia për mediat, qoftë ato të shkruara, apo audio-vizive.

Në Ulqin deri në datën 20 shkurt

Vllaznia do të qëndrojë në Ulqin rreth një javë që të stërvitet në kushte më të mira atmosferike. Drejtuesit e skuadrës shkodrane e kanë marrë këtë vendim menjëherë pasi kanë mësuar se Federata Shqiptare e Futbollit ka shtyrë të gjitha ndeshjet deri më datën 23 shkurt. Ky veprim ka favorizuar në njëfarë mënyre kuqeblutë pasi ata kanë udhëtuar drejt Malit të Zi, dy ditë më parë, për t'u përgatitur për ndeshjen e radhës me Skënderbeun. Pasi janë shtyrë ndeshjet, shkodranët do të vijojnë të stërviten atje së paku dhe për 7 ditë të tjera.

Një ndër arsyet e realizimit të stërvitjes në Ulqin është mungesa e ambienteve sportive për shkak të mbulimit nga dëbora. Ndërkohë që në shtetin fqinj, fatmirësisht fushat e stërvitjes janë në kushte të mira për stërvitje. Përveç kësaj, udhëtimi i skuadrës drejt Ulqinit, ka qenë dhe një kërkesë e trajnerit Vata që ekipi t'i shmangte kontaktit të drejtpërdrejtë me mediat apo sportdashësit

Drejtues-trajner-lojtarë... treshja nuk funksionon

Skuadra e Vllaznisë është në një udhëkryq të vërtetë. Qoftë drejtuesit, stafi teknik, por dhe lojtarët janë tre hallka që nuk po koordinohen dot me njëri-tjetrin. Akush nuk di të japë një mendim të qartë nëse ekipi duhet të mendojë për krijimin e raportve dhe të një mirëfunksionimi të skuadrës apo të mendojë për ndeshjet dhe të përqendrohet tek stërvitja. Drejtuesit e skuadrës janë në një "luftë" të hapur me trajnerin Vata, ndonëse publikisht dhe nga deklaratat e tyre jashtë mediave e mohojnë një gjë të tillë. Vetë trajneri është në një raport aspak të mirë me lojtarët. Këta të fundit e konfirmojnë një gjë të tillë sigurisht në mënyrë konfidenciale pasi, tashmë, duhet të respektohet "heshtja e shtypit". Situata në të cilën ekipi ndodhet është me të vërtetë një kaos pa rrugëdalje. Por ajo që do ta pësojë në fund është Vllaznia.

A.Z.

"Kërkojmë mirëkuptimin e mediave dhe të gazetarëve pasi ne si Vllazni dhe të gjithë ju, jemi të interesuar që skuadra të arrijë objektivat, duke respektuar heshtjen që kemi vendosur, shpresojmë që shumë shpejt të rikthehet dhe komunikimi që kemi patur deri tani", mbyllet deklarata

Një ndër arsyet kryesore pse është marrë një vendim i tillë ka të bëjë me faktin se lojtarët, apo dhe trajneri, kanë ndërmarrë akuza të ndërsjella në media. Në fakt, rituali i akuzave tek Vllaznia ka nisur nga ana e trajnerit Rudi Vata në një prej të përditshmeve sportive kundër administratorit të klubit, Kujtim Shaba



Trajneri Vata, publikisht ka akuzuar mbrojtjen dhe lojtarët për humbjen ndaj Laçit. Kjo ka nxitur që shumë futbollistë dhe madje ai që mori guximin, Dritan Smajli, të sqarononte se e gjithë skuadra nuk po funksiononte më së miri. Ndaj, duke parë që situata po dilte jashtë kontrollit, drejtuesit e panë të arsyeshme të bllokoni të gjitha intervistat apo kontaktet me mediat dhe gazetarët

A do të zgjidhë gjë?!

Është e drejtë e çdo klubi që të marrë vendime për heshtje apo prononcime për mediat. Vllaznia në situatën në të cilën ndodhet aktualisht mori rrugën më të thjeshtë të mundshme, me idenë që do të qetësonte skuadrën, lojtarët por dhe stafin teknik. Në fakt, një "black-out" në këtë mënyrë nuk i zbeh apsak problematikat me të cilat po përballlet skuadra. Drejtuesit, në vend që të marrin në analizë dhe të informojnë opinionin publik se çfarë do të bëhet me skuadrën për mungesë rezultatesh, bëjnë që çdo informacion apo vendim të jetë në "terr" të plotë. Heshtja e shtypit tregon dhe njëherë se Vllaznia më kot tenton t'i shmangte problemeve dhe situatës në të cilën ajo ndodhet, në vend që t'i zgjidhë ato.

Shkëmbi: Tani jemi katër për të fituar titullin kampion!



Bledi Shkëmbi

Kapiteni i Skënderbeut: “Nuk dihet si do shkojnë ngjarjet, por nëse ruajmë ritmin do jemi sërish fitues të kampionatit”

Kapiteni i Skënderbeut, Shkëmbi, mendon se skuadra e tij i ka të gjitha shanset që të dalë sërish kampione e Shqipërisë

- Shkëmbi, ky vit ka nisur ndryshe për Skënderbeun, apo jo?
- Unë do të thoja se jemi

në rrugën e duhur, rrugë të cilën e kemi pasur të mbarë që nga gjysma e fazës së parë. Pastaj mos harroni se dhe vitin e kaluar e kemi mbyllur në mënyrën më të mirë.

- Tri ndeshje të luajtura në këtë fillim viti, 3 fitore. E kishit menduar kështu?

- Që skuadra do të jepte maksimumin, për këtë kam qenë i bindur. Dhe jo vetëm unë, por dhe të tjerët. E gjithë kjo vjen pas asaj përgatitje në periudhën përgatitore në Antalia. Shkurt, e gjithë skuadra ka ardhur në maksimum, ndaj jemi aty ku duhet.

- Atëherë, çfarë ka ndryshuar tek Skënderbeu?

- Mbi të gjitha, ritmi. Tani jemi në një ritëm të

lartë. E gjithë skuadra, dhe kjo mendoj se është tepër e rëndësishme për një skuadër që kërkon të marrë maksimumin nga një sezon.

- Ndaj, tani shkohet më shpejt tek porta?

- Sigurisht që dhe për këtë arsye.

- Kjo ka qenë dhe kërkesa e Levit?

- Duhet ta themi se trajneri që kur ka ardhur tek Skënderbeu e ka pasur këtë kërkesë: “Të shkohet sa më shpejt të jetë e mundur në zonën kundërshtarë”. Me një grup lojtarësh në maksimum të gjitha janë të mundura, mbi të gjitha loja e shpejtë, lojë të cilën në përqindje të madhe e kemi treguar edhe në këto tri ndeshje të këtij viti.

- Shkëmbi, sa e lehtë është të ruhet ky ritëm?

- Për një skuadër që i ka lojtarët e duhur për të synuar majën e renditjes sigurisht që është e lehtë të ruhet ky ritëm. Për ta ruajtur ritmin e duhur trajneri ka plotësuar më së miri skuadrën me lojtarët e duhur.

- Pas fitores me beratasit dhe humbjes së Teutës me tiranasit, kampionati është rihapur

- Si asnjëherë tjetër, tani janë më tepër se katër skuadra që kërkojnë të ngjiten sa më parë të jetë e mundur në krye të renditjes.

- Një diferencë si kjo, një pikë larg tiranasve e tri larg durrsakëve, e kishit menduar kaq shpejt?

- Të gjithë lojtarët e Skënderbeut, bashkë me stafin, në mos e kishim menduar këtë diferencë kaq shpejt, të paktën tani që është radha e ekipeve të tjera për të gabuar, këtë e kemi thënë prej javësh.

- Ju mendoni se tani është radha e Teutës për të gabuar?

- Unë nuk përmenda emra ekipesh, por vetëm thashë se për Skënderbeun gabimet janë mbyllur. Njëherë e mirë për këtë sezon.

- Shkëmbi, në takimin

Teuta-Tirana për cilën skuadër keni bërë tifo?

- Të jetë për tifo, pas Skënderbeut, nuk e kam fshehur asnjëherë, bëj tifo për Teutën, për atë se kam kujtime të bukura me këtë ekip, por, në këtë takim të gjithë ne të Skënderbeut kemi bërë vetëm llogari.

- Të cilat ju kanë dalë...?

- Fakti që tashmë Teutën nuk e kemi më larg se tri pikë dhe Tiranën vetëm një, llogaritë tona kanë dalë qind për qind.

- Ndeshjet e radhës janë, Skënderbeu-Dinamo, Tirana-Kastrioti, Flamurtari-Teuta. Mund të flasim për “llogari” edhe për këto takime?

- Në këtë gjysmë të dytë të kampionatit, të gjitha takimet janë llogari më vete për të gjitha skuadrat.

- Duke mbetur tek këto tri çifte, pas këtyre takimeve, do të kemi tjetër renditje?

- Kjo mbetet për t'u parë.

- Në “letër”, Skënderbeu duket pak më i favorizuar.

- Në plan të parë edhe të duket kështu. Për të fituar një takim duhet të jemi në maksimum, edhe kur luajmë me një ekip që për fatin e keq është në fundin e renditjes.

Intervistoi: TONI FRROKU

“Tomori humbi, por fitoi standardet”

Shameti: “Nëse do ishim treguar më të kujdesshëm, mund të kishim marrë një pikë nga kjo ndeshje. Tifozëria jonë u tregua e shkëlqyer në mënyrën se si na ndihmoi, duke mos krijuar as incidentin më të vogël”

Lojtarët e Tomorit kanë qenë të zhgënjyer nga humbja 2-4 kundër Skënderbeut dhe dje në unison të gjithë kanë pasur mendimin që ekipi ka merituar të paktën një pikë në këtë sfidë. “Më

vjen keq që humbëm, - thotë Shameti, - nëse pjesa e parë do kish përfunduar me rezultatin 1-1. Nëse do kish filluar me këto shifra dhe pjesa e dytë me siguri që ne do kishim administruar lojën, sepse kemi humbur dhe shumë raste. Na vjen keq sepse dhe në momentin kur ndeshja shkoi 2-2 ne prapë u goditëm shumë shpejt. Megjithatë, në fund të fundit, ne ndihemi të gëzuar sepse në fushë u luajt pastër dhe e pranuan me sportivitet humbjen. Për t'u vlerësuar janë dhe tifozët tanë të cilët sigurisht u sollën ashtu si duhet, duke na ndihmuar e duke na mbështetur dhe duke mos prodhuar asnjë incident”.

EDI SPAHIU

Shkumbini: Një barazim që nuk na vjen përshtat

Shenaj: “Kundër Bylisit mund të fitonim, ndeshjen e kemi kontrolluar ne”

Barazimi i së shtunës ndaj Bylisit, për mesfushorin gjirokastrit, Shenaj, kanë qenë tre pikë të humbura. Loja në pjesën e dytë në veçanti ka folur më shumë për peqinasit, duke shpërdoruar një mori rastesh. Por, për Shenajn vëmendja duhet kthyer në takimin e transfertës së Fierit me Apolloninë. “Ka qenë një ndeshje të cilën

e kishim vlerësuar si të vështirë, - shprehet Shenaj. - E kishim vlerësuar përballjen, duke u ruajtur nga çdo nënvlerësim të kundërshtarit. Dua të theksoj se edhe në pjesën e parë ekipi ynë ka vënë në vështirësi ekipin ballshiot. Një moment pasigurie ka qenë fatal për ne. Por sikurse edhe në ndeshje të tjera, ne kemi arritur të kthejmë rezultatin e takimit. Në pjesën e dytë kemi pasur raste jo thjesht për të barazuar, por edhe për të fituar këtë takim. Por, tashmë na duhet që t'i kthehemi përgatitjeve për takimin e radhës ndaj Apollonisë vendase. Shpresojmë që të japim maksimumin në këtë sfidë për të arritur një rezultat pozitiv”, ka mbyllur Shenaj.

LULZIM RESULI

Trajneri italian, De Vekis: “Në dy javët që nuk do luhet futboll, duhet të mbajmë në gjendje konstante formën fizike të lojtarëve”

Shtyrja e kampionatit dhe Kupës për dy javë, duket se ka prishur planet e trajnerit të Kamzës, Mauro De Vekis. Italiani ka folur për dy çështjet e aktualitetit, që janë lajmi kryesor në periferi të Tiranës: humbja me Flamurtarin dhe shtyrja e ndeshjeve zyrtare për shkak të motit të keq që ka përfshirë vendin tonë. “Kur humb ndeshje si ajo me Flamurtarin, mund të them se si përfundim duhet të marrësh vetëm paraqitjen e mirë. Jemi përmirësuar nga ndeshja në ndeshje, pavarësisht se ndaj Kastriotit dhe Bylisit morëm nga një pikë. Loja jonë ka ardhur duke u rritur dhe kjo është baza ku duhet të mbështetemi për

Kamza mendon për një tjetër “fazë”

të vazhduar punën e mirë që kemi filluar. Të gjithë u mërzitëm për rezultatin, por kjo mund të kthehet në favorin tone, duke shtuar dëshirën për të kërkuar pikë”.

Më pas ish-trajneri i PRO Patrias ka thënë se, shtyrja e kampionatit dhe Kupës ka prishur disi planet e skuadrës së tij. “Absolutisht nuk dua të diskutoj për vendimin, sepse ata persona që e kanë marrë, kanë patur arsyt e veta dhe nga një anë mund të jem edhe dakord për këtë gjë. Megjithatë, dua të them që skuadra jonë ishte në një moment të mirë. Kishim planifikuar çdo gjë që nga dita ime e parë në krye të stollit kamzali dhe ky vendim na ka çekuilibruar disi. Tani duhet të ndryshoj programin dhe me siguri që do t'i rikthehemi stërvitjes me

dy seanca në ditë. Ndërkohë që nga ana fizike nuk mendoj se do të shtoj ndonjë gjë më shumë, sepse në atë aspekt nuk kemi patur problem. Ndërkohë që duhet të punojmë shumë për sulmin dhe për konkretizimin përpara portës. Madje në ditën e sotme kam parë edhe mërzitjen e lojtarëve, të cilët mezi presin të zbrasin në fushën e lojës dhe kjo gjë më pëlqen shumë sepse tregon dëshirën e madhe që kemi për të bërë mirë”.

Në fund, trajneri De Vekis ka folur edhe për anën pozitive të këtij vendimi. “Meqë do t'i rikthehemi stërvitjes me dy seanca në ditë, të shtuën dhe të dielën e ardhshme do ta bëjmë pushim dhe besoj se do të shkoj në Itali për të takuar familjen time”.

JENDRIT SHABANAJ

Pogradeci, portieri do një fanelë titullari

Petrovski: “E tregova veten, madje jo vetëm me penalltinë e prituri ndaj Kastriotit. Tani dua të luaj unë titullar, sepse e meritoj!”

jetë për shumë kohë portieri i parë i liqenorëve. Pas përfundimit të takimit, për “Sport Ekspres”, Petrovski shprehet: “Nuk jam shumë i kënaqur me barazimin. Me lojën që zhvilluam duhet ta kishim fituar takimin. Më duhet të them se edhe gjyqtari nuk ka qenë në nivelin e duhur. Më

vjen mirë që jam kthyer në formacion të parë dhe do të bëj të pamundurën për të mos e lëshuar më. Jam i kënaqur që kam pritur penalltinë dhe i kam dhënë ekipit një mundësi për të shpresuar. Jam në portë për ta mbrojtur atë dhe do ta bëj sa herë të më jepet mundësia”, ka përfunduar portieri, Petrovski. Ndërkohë, trajneri Çekiçi thotë se: “Edhe një pikë nuk është keq, por duke parë ecurinë e lojës kam ngelur i shtangur nga përfundimi i saj. Mund të kishim marrë 3 pikë dhe këto me meritë. Dua të them se gjyqtari nuk ka qenë në lartësinë e duhur me vendimet e tij. Gjithsesi ne do të vazhdojmë me lojën tone, duke dhënë gjithmonë më të mirën”, ka thënë Çekiçi.

TAULANT KOKONESHI

Tirana, trofeun e parë në futboll?!

Shtypi i kohës, zbulon se në 1911-ën, në Fier është zhvilluar një turne mes disa skuadrave që kanë parë si fituese skuadrën e Tiranës me kapiten Zyber Hallullin

Tirana ka si datë zyrtare të krijimit të saj, 16 gushtin e vitit 1920. Pas hulumtimeve në arkiva të ndryshme, historianë shqiptarë, kanë arritur të zbulojnë fakte të reja për hapat e para të topkëmbës në Shqipëri. Një turne i viti 1911, zhvilluar në Fier (10 vjet më herët sesa të shfaqeshin klubet në formën e tyre të riorganizuar të viteve '20), ku merrnin pjesë qytetet: Tiranë, Lushnje, Kavajë, Peqin, Berat, Elbasan, Vlorë dhe Fier. Kampion në këtë turne është shpallur Tirana, sipas gazetës "Zgim e C'qipërisë", e vitit 1912.

Turneu futbollistik i Panairit të Fierit Ja çfarë shkruan një gazetë e vitit 1911

"Në Rahije të Fierit, bëhet një panair i madh. Në këtë panair kishin ardhur nga Tirana, Elbasani, Kavaja, Peqini, e nga vise të tjera. Për të mbledhur të hollat e vendit që ne shitblerësit, katundaria kish shënuar të birë e Mydyrit. Këtu u mblodhën shumë popull, ku me këtë rast u zhvillua dhe një aktivitet sportiv, top kambe, me skuadra të formuara nga qytetarë e katundarë të ardhur nga këto qytete, gjithsej 8 skuadra, që u

ndeshën në këtë lojë të re, për të fituar një shpërblim, e cila kishte një vlefë sa 6 monedha ari." Nga data 7-14 Prill 1911, në qytetin e Fierit, u zhvillua një turne futbollistik, me pjesëmarrjen e 6 skuadrave, të asaj kohe: Tirana, Kavaja, Peqini, Fieri, Lushnja, Berati dhe Vlorë. 8 Skuadrat u ndanë në 4 çifte duke u ndeshur me sistemin e eliminimit, me nga një takim. Më pas 4 fitueset, ndeshen në gjysmëfinale dhe më pas në finale. Të gjitha takimet janë

luajtur në Fier. Tirana u shpall fituese e turneut në Panairin e Fierit. Kupën dhe çmimin e mori kapiteni i Tiranës, z.Zyber Hallulli", (marrë nga gazeta "Zgim e C'qipërisë", me drejtor Abdyl Kadri, e datës 21. 04. 1911, fq.2, art.174.)

Pas këtyre fakteve të dala në dritë së fundmi, ngrihet pyetja: A duhet parë dhe rivlerësuar dhe njëherë tjetër historia dhe hapat e para të futbollit shqiptar?!

ARBILAÇI

Çerekfinale finale: (Fier, 7-10 prill 1911)

07.04.1911	Tirana - Elbasani	9-4
08.04.1911	Kavaja - Berati	8-2
09.04.1911	Peqini - Vlorë	11-3
10.04.1911	Fieri - Lushnja	6-2

Gjysmëfinale

11.04.1911	Tirana - Kavaja	4-0
12.04.1911	Fieri - Peqini	2-16

Finalja (Fier, 14 prill 1911)

Tirana - Peqini	6-1
-----------------	-----

Duro rikthehet... por bën stërvitje i vetëm

Tirana e ka pezulluar, Duro ka zgjedhur të paraqitet në stërvitje sikur të mos ketë ndodhur asgjë. Trajneri Hulian Rubio e ka vendosur: për mesfushorin, nuk ka vend në skuadrën e tij. Dje Klodi ka ardhur në "Skënder Halili", njësoj si çdo futbollist tjetër i Tiranës, por ka qenë i detyruar të stërvitet veçmas grupit. Me kërkesë të spanjollit dhe vendim të klubit, Duro është i pezulluar deri në një afat të papërcaktuar. Ai ka zgjedhur të komentojë atë çfarë ka ndodhur të premtën para ndeshjes me Teutën, pozicionin e tij aktual dhe të ardhmen: "Shumë gjëra janë keqkuptuar dhe unë pres që gjithçka të zgjidhet sa më shpejt të jetë e mundur. Në momentin që flasim, jam i detyruar të stërvitem i diferencuar. Po kaloj një gjendje gripale dhe gjithashtu jam i pezulluar. Nuk e di se çfarë nënkuptohet me fjalën "pezullim", pasi ky vendim është marrë nga trajneri dhe tashmë dihet që unë nuk kam një raport të mirë me të. Jam futbollist i Tiranës jo për herë të parë. Kam luajtur për këtë skuadër disa vite. Kam dhënë maksimumin në fushë dhe jashtë saj për këtë fanelë. Kam kërkuar të mbroj interesat e klubit e kështu do të bëj gjithmonë. Jam këtu për të luajtur futboll dhe jo rastësisht kam zgjedhur Ti-

Lojtari, pas polemikave me Rubion: "Pres që ai të më rikthejë në skuadër". Ndërkohë, trajneri nuk e preferon dhe Klodi bën vrapime anash fushës. Është i pezulluar

ranën. Kam patur disa oferta nga jashtë dhe brenda vendit, por zgjedha të luaj në këtë klub, të cilin unë e dua. Jo për arsye financiare", ka deklaruar Duro.

Pozicioni-Që pas ndeshjes me Teutën, mesfushori zyrtarisht është i pezulluar dhe nuk ka të drejtë të stërvitet apo të luajë me skuadrën bardheblu, deri në një moment të dytë. Duro pranon këtë vendim, por në krahun tjetër zotohet se do të vijojë përgatitjet për të qenë i gatshëm kur Tirana ta kërkojë: "Unë jam pjesë e Tiranës. Do të stërvitem dhe do të luaj futboll. Kur të kenë nevojë për mua unë do të jem i



Klodian Duro

gatshëm të zbres në fushë e të jap më të mirën. Karriera ime nuk mund të prishet për një keqkuptim. Në çdo skuadër ku kam luajtur, kam respektuar trajnerin, pavarësisht emrit apo vendit se nga vjen.

Mendoj se meritoj pak më tepër respekt. Gjatë kohës që klubi kishte probleme financiare, për asnjë moment nuk kam kërkuar asgjë dhe zgjedha të mos bëja asnjë polemikë. Ato para që do të marr gjatë qëndrimit tim këtu, të jeni të bindur se do t'ia dhuroj sërish Tiranës. Koha do të vërtetojë këto që them", ka vijuar prononcimin e tij, mesfushori bardheblu.

Incidenti - Disa ditë pas asaj që ndodhi në Durrës, para fillimit të ndeshjes me Teutën, Duro ka zgjedhur t'i rikthehet sërish për të sqaruar edhe njëherë atë çfarë ka ndodhur: "Nuk e kisha kaluar ende plotësisht gjendjen gripale dhe zgjedha të vihesha në dispozicion të ekipit. Për asnjë moment nuk kam kërkuar të jem pjesë e formacionit, pasi këtë vendim e merr trajneri. Unë kërkoja një shpjegim, që nuk m'u dha. Kjo bëri më pas që gjërat të keqkuptoheshin. Më erdhi mjaft mirë që skuadra arriti të fitonte në një ndeshje mjaft delikate. Dua të falënderoj të gjithë shokët e ekipit për atë që treguan në fushë dhe fitoren e marrë në momentin e duhur. Tirana është për titull dhe të gjithë bashkë do të luftojmë për t'ia dalë me sukses", ka përfunduar deklarimet e tij, Klodian Duro.

ARBILAÇI

Spanjollit i stolisit bardheblu, Hulian Rubio ka vendosur të mos pranojë Klodian Duron në skuadër, deri për një afat ende të papërcaktuar. Tirana dje ka rinisur përgatitjet dhe tekniku ka refuzuar të polemizojë me lojtarin e tij, duke zgjedhur të kthejë vëmendjen tek futbollit i luajtur. "Nuk kam ndërmend të flas për atë çfarë ka ndodhur. Që ditën e parë që kam ardhur këtu, kam deklaruar publikisht se nga unë nuk do të dëgjoni kurrë fjalë të këqija për dikë dhe mos prisni të polemizoj për asnjë çështje. Do të flas vetëm për futboll dhe asgjë tjetër; ndaj kërkoj nga të gjithë që mua të më pyesin vetëm për të tilla çështje", ka deklaruar spanjollin, Rubio. Më pas, ai ka folur për pezullimin dyjavor të kampionatit dhe pak për fitoren e arritur ndaj Teutës. "Shytyrja e kampionatit nuk na shërben, por kjo nuk do të thotë se na janë prishur planet. Vinim pas një fitoreje dhe mendoj se duhet ta kishim shfrytëzuar këtë moment. Nuk qe e thënë të ndodhte kështu, por nuk është fundi i botës. Kampionati u shty edhe për rivalët tanë, e kjo na bën të punojmë në kushte të barabarta. Fitorja ndaj Teutës?! Ishte një fitore e merituar,

Rubio: "Mos më pyesni për këto gjëra!"

Trajneri spanjoll nuk komenton çështjen e Klodit, duke thënë se tanimë vendimi është marrë. Kampionat i shtyrë? "Na prish planet, sepse ishim në eufori pas fitores kundër Teutës"

por që tashmë i përket të kaluarës. Unë i harroj shpejt sukseset, ashtu si dhe humbjet", ka përfunduar tekniku bardheblu, fjalën e tij.

Tafaji - Drejtori sportiv, Albani Tafaji, ka folur për rastin "Duro" dhe pozicionin që lojtari ka tani në skuadër. Shkurtimeisht, ai ka shpjeguar atë çfarë Tirana ka vendosur për të: "Trajneri më tha që nuk e do lojtarin në stërvitje. Në këtë mënyrë, ne do të zbatojmë kërkesën e tij. Kjo do të thotë se Klodian Duro është i pezulluar deri në momentin që do të mblidhet bordi drejtues. Deri kur të ndodhë kjo, pezullimi mbetet në fuqi", ka bërë të ditur Tafaji. A.L

Premio në rrezik?

Parmbrëmë, Bashkia e kryeqytetit vendosi të akordojë 100 mijë euro në ndihmë të zonave të izoluar nga moti i keq. Shifra është e njëjtë me atë të premtuar për fitoren me durrsakët...

Një muaj më parë, kryebashkiaku i Tiranës, Lulëzim Basha, i premtoi skuadrës bardheblu, 100 mijë euro në rast fitoreje ndaj Teutës. Tirana arriti të kalonte me sukses këtë sfidë ndërkohë që tani pritet shpërblimi i premtuar. Burime konfidenciale pranë bordit drejtues, kanë bërë

të ditur se vetëm kryebashkiaku mund të mbulojë këtë shumë të madhe financiare. Shoqëria akcionere nuk i ka mundësitë financiare për të dhënë 100 mijë euro shpërblim dhe lojtarët duhet të kërkojnë premion e premtuar, në zyrën e kryebashkiakut Basha.

Kritikat e presidentit? Te Teuta askush nuk kthen përgjigje

Pas dy ditëve pushim dje durrsakët i janë rikthyer stërvitjes për takimet e ardhshme. Para kësaj seance, stafi teknik dhe futbollistët kanë realizuar një analizë të ndeshjes të humbur të premtën e kaluar përballë Tiranës. Bregdetarët shpresojnë që kjo humbje të jetë e kufizuar dhe skuadra të kthehet sa më shpejt tek rezultatet pozitive. Pas kritikave të presidentit Edmond Hasanbelliu një ditë më parë, lojtarët dhe stafi nuk kanë preferuar të bëjnë komente rreth prononcimit të tij, ndërsa janë përqendruar vetëm te stërvitja, me qëllimin për t'u kthyer sa më shpejt tek loja e mirë

dhe pikët. Me gjithë humbjen e pësuar, kjo ndeshje nuk ka patur vetëm elementë negativë për durrsakët. Sulmuesi, Mirel Çota, ka treguar se është në një formë shumë të mirë duke qenë i vetmi lojtar që alarmonte mbrojtjen bardheblu. Falë aftësisë së tij personale ka arritur të barazojë përkohësisht rezultatit e ndeshjes. Sulmuesi tregon se do të kishte dashur që goli i tij të kishte vlera trepikëshi, ndërsa thotë se: "Ne shpresonim shumë që ta nisim me fitore fazën e dytë, por fatkeqësisht nuk kemi mundur të dalim tek loja që ne dëshironim. Jemi goditur me gol shumë shpejt, i cili ka prishur disi

strategjinë tonë të lojës për këtë ndeshje. Kemi barazuar në fund të pjesës së parë, dhe më pas loja ka qenë nën kontrollin tonë. Kur pritej të vinte goli ynë, kemi pësuar në mënyrë aksidentale golin e dytë. Në këtë ndeshje kam përjetuar një moment shumë të bukur, kur kam shënuar në fund të pjesës së parë, për më tepër që kënaqësia shpesh dhe më shumë kur shihje "Niko Dovanën" në një atmosferë shumë festive. Do të dëshiroja shumë ta ndërroja golin tim, vetëm skuadra të ishte fituese në fund të kësaj sfide". Për Çotën, goli i shënuar të premtën ka qenë i pesti i shënuar gjatë këtij kampi-

Një ditë më parë, Hasanbelliu akuzoi lojtarët dhe stafin teknik për paraqitjen e dobët ndaj Tiranës. Drejtuesit nuk flasin, ndërkohë që Çotës i vjen keq që goli i tij nuk i dha së paku një pikë skuadrës

onati. Goleadori shpreson që të vazhdojë të shënojë, por ajo çka dëshiron më shumë është kthimi i Teutës sa më shpejt tek sukcesi: "Nuk e mohojmë që ka qenë një humbje e dhimbshme, pasi me këtë humbje i dhamë mundësinë të gjithë kundërshtarëve të na afrohen më shumë në renditje. Por nuk duhet të lejojmë që kjo humbje të ndikojnë në moralin tonë dhe në ecurinë e ndeshjeve të ardhshme. Duhet të korrigjojmë gabimet tona dhe të tregojmë që kjo humbje ishte

një rastësi, pasi i ndodh çdo lloj ekipi që të jenë në një ditë të errët".

Humbet-Gjatë këtij kampionati, Teuta ka pësuar vetëm dy humbje, ndaj Vllaznisë në Shkodër në fazën e parë dhe ajo e disa ditëve më parë përballë Tiranës. Në të dyja këto takime durrsakët kanë gjetur golin me anë të sulmuesit Çota, që ka shënuar gola shumë të bukur por që, për fat të keq nuk i kanë vlejtur ekipit të tij për të marrë tri pikët.

BLEDA KADIU



Në foto: Çota duke festuar golin e barazimit të përkohshëm me Tiranën. Në fund, bardheblutë fituan me rezultatin 2-1

Skuadra e Kastriotit nuk ka arritur dot të shkojë më tepër se një barazim 1-1 në takimin e parë të fazës së dytë në një fushë neutrale, atë të stadiumit "Ruzhdi Bizhuta" të Elbasanit. Ky barazim për skuadrën e Ndreut ishte i dyti radhazi, ku në takimin përmbyllës të fazës së parë ka arritur të barazojë në "Niko Dovanën" ndaj kryesuesve të Teutës, 1-1. Ndeshja e dy ditëve më parë ka pasur dy tablo. Një pjesë e parë në disavantazh të kundërshtarit dhe në pjesën e dytë skuadra e Kastriotit ka pa-

Kastrioti, zhgënjën Inkango: Më falni për penalltinë!

Sulmuesi më i rëndësishëm i skuadrës mund t'i jepte një impuls më shumë lojës nëse do godiste saktë. Në fund vetëm 1-1 kundër Pogradecit

sur rastin më të artë për të barazuar me anë të Inkangos, i cili nuk është treguar i saktë në gjuajtjen e penalltisë, pasi ka pritur portieri pogradecar. Pas shumë përpjekjesh, kur u mendua se takimi mund të mbyllej në avantazh të Kastriotit, në minutat e fundit ka ardhur edhe goli i barazimit. Pas ndeshjes Inkango shprehu keqardhjen e tij për golin që nuk arriti të shënonte. "Do të doja sigurisht ta dërgoja topin në rrjetë, më vjen keq për stafin dhe për tifozët".

BEHAR SALLAKU

Shtyrja e kampionatit për shkak të motit, ka ndikuar pozitivisht tek skuadra kurbinase. Për momentin laçianët kanë 2 lojtarë të cilët janë rikthyer nga dëmtimi, por nuk janë akoma në kondicionin e duhur fizik ndaj nuk janë grumbulluar akoma nga trajneri Daiu. Mesfushori i krahut të majtë, Elio Shazivari, si dhe sulmuesi Bledar Marashi janë bashkuar prej kohësh me skuadrën, por lojtarët kanë qëndruar për një kohë të gjatë jashtë fushave të blerta, ndaj forma e tyre nuk është e njëjtë me pjesën tjetër të grupit. Kjo periudhë do t'i shërbejë për mirë këtyre lojtarëve që të paktën në ndeshjen e radhës të jenë në stolin e rezervave. Gjithashtu në seancën e djeshme stërvitore sulmuesi kryesor i skuadrës, Vilfor Hysa, është stërvitur i diferencuar nga pjesa tjetër e grupit. Lajmi për shtyrjen e ndeshjeve i ka mundësuar trajnerit Daiu

Laçi, tre të dëmtuar marrin "frymë" lirisht

Hysa, Shazivari e Marashi do të kenë tanimë gjithë kohën e mjaftueshme për të qenë në 100% të gjendjes fizike, në ndeshjen e parë që do të luhet pas rikthimit të kampionatit

që ta lërë sulmuesin të vrapojë i lirë rreth fushës. Lojtari nuk ka dashur që ta stërmundojë kavigjën e tij, duke kryer vrapime të lehta. Për fatin e mirë të skuadrës, shtyrja e kampionatit ka ndikuar pozitivisht pasi sulmuesi mund të rikuperohet plotësisht me kohë të plotë, duke mos u detyruar të bëjë një rikthim të parakohshëm.

MARIO NIKOLLI

Fituesi i Kupës së Nigerisë në Ballsh: Këtu luhet ashpër!

Bola Olalekan, 20-vjeçar, vjen nga një aventurë në Ligën e Kampionëve në Afrikë: "Mund të rritem në Shqipëri, por sikur të luhej pak më butë, do ishte më mirë"

Lojtari i ri nigerian i Bylisit, Bola Olalekan, ka mbushur 20 vjeç në Shqipëri. Ai ishte titullar edhe në ndeshjen ndaj Shkumbinit në fundjavë (1-1) dhe u largua nga fusha pasi pësoi një dëmtim në pjesën e dytë të lojës, duke u zëvendësuar nga Shoshi. Tashmë Bola ka hyrë në brendësi të skemave të Shensoit dhe besohet se këtë sezon ai mund të jetë pjesë e rëndësishme e organikës së Bylisit. Nigeriani nga Lagosi mund të luajë në disa pozicione të fushës, duke qenë një lojtar "polivalent" që di të gjejë edhe rrugën e golit. Ai ka ardhur tek Bylisi pasi ka fituar Kupën e Nigerisë me ekipin e tij, Ocean Boys, dhe pasi është aktivizuar edhe në Champions League Afrikane si pasojë e fitimit të Kupës. Edhe pse në një moshë të re, ai ka lënë përshtypje tek kjo skuadër dhe në janarin e këtij muaji u transferua tek Bylisi. Ai erdhi së bashku me një grup të tjerë lojtarësh nga Nigeria dhe kjo atmosferë duket

se i ka lehtësuar përshtatjen edhe Bolas. Në sfidën ndaj Shkumbinit, ai bëri debutimin e tij në Superligë, ndërsa e kishte veshur fanelën e Bylisit edhe në Kupë ndaj Kamzës. Kampionatin shqiptar, 20-vjeçari nga Nigeria e sheh si një eksperiencë të re dhe pozitive për karrierën e tij, por nga ana tjetër ai tregon edhe një anë negative të fushave shqiptare: "Kjo është një eksperiencë e re për mua dhe besoj se do të jetë shumë pozitive për vazhdimin e

karrierës sime. Bylisi është një ekip me projekt ambicioz dhe që i trajton mjaft mirë lojtarët e tij, ndaj jam i bindur se është vendi i duhur për mua. Tashmë ne jemi ambientuar më së miri dhe këtu është krijuar një atmosferë shumë miqësore për ne, aq më tepër që mund të flasim edhe gjuhën tonë. Kam si synim që ta bind stafin dhe trajnerin sa më shumë për aftësitë e mia, ndaj çdo minutë në fushë është pozitive. Por ajo që shoh unë në kampionatin shqiptar është se ekziston një lojë shumë e ashpër. Këtë gjë e pashë edhe në ndeshjen e fundit që luajtëm ku loja ishte shumë agresive, madje unë pësova edhe një dëmtim në pjesën e dytë dhe dola jashtë fushës", përfundon 20-vjeçari, Olalekan.

ENEA METAJ

www.sportekspres.com



➤ Lajmet më të fundit, gjithçka rreth aktualitetit të futbollit shqiptar, kombëtares, legionarëve dhe ngjarjeve nëpër botë

➤ Forum, sondazhe dhe komente, për të gjithë ata që duan të bëhen pjesë e zërit të "Sport Ekspres"

➤ Ndiqni ndeshjet e kombëtares, e klubeve tona në Europë dhe të Superligës në kohë reale në faqen tonë të internetit



Apolonia ringjall shpresat, Dinamo "buzë greminës"

DINAMO 3
APOLONIA 3

Shënues: Arifaj 13, 61', Kuli 34' (p)
/ Gërxho 17', 31', Rama 51

E hënë, 13 shkurt 2012, ora 14:00, në stadiumin "Qemal Stafa" të Tiranës

Nga Dritan IKONOMI

Dinamo: Osmani, Peqini, Malota, Kaja, Grami (Imami 55'), Deliallisi, Arifaj, Djarmati, Bilibashi (Daja 55'), Shtini, Kuli. Trajner: A. Mergjyshi

Apolonia: Xhixha, Llënga, Ibrahim, Muçaj, Saljevski (Nako 63'), Sinani, Gërxho, Selimi, Riba, Rama, Qafa (Naçi 46'). Trajner: M. Papuçiu

Gjyqtarë: E. Peza, A. Pregja, E. Qirici

Kartonë të verdhë: Shtini / Muçaj (2)

Kartonë të kuq: Peqini / Muçaj

Gërxho dhe Rama dhurojnë spektakël, blutë luftojnë me zemër dhe krijojnë raste, por kaq nuk mjafton kundër dhjetë fierakëve



Gërxho (m) feston golin e dytë për Apoloninë

Gjashtë golat e shënuar nga Dinamo dhe Apolonia në fund të 90 minutave kënaqën vetëm futbollistët e Tomorit, disa prej të cilëve ishin në "Qemal Stafa" për të ndjekur takimin midis dy kundërshtarëve direkt në luftën për mbijetesë në Kategorinë Superiore. Shifrat e barabarta midis tyre i voliten më tepër skuadrës beratase, mbajnë gjallë shpresat e Apolonisë dhe kanë shuar pothuajse plotësisht shanset e Dinamos. Dy skuadrat e vendeve të fundit e shfaqën qartë synimin për të rrëmbyer tri pikët, me vlerë të jashtëzakonshme pas humbjes që kishte pësuar më parë Tomori nga Skënderbeu. Mergjyshi kishte futur në formacion katër nga për-

forcimet e janarit, ndërsa Papuçiu kishte përfshirë të rikthyerin pas një mungese të gjatë, Reinaldo Ramën. Në një terren të rënduar, gabimet ishin të shumta, megjithatë secila prej skuadrave arriti të kryente aksione të rrezikshme. Kur Arifaj shënoi golin e parë në minutën e 13-të, u duk se fitorja e parë e bluve do të ishte veç formalitet, pasi vendasit po shfaqeshin më mirë. Por, Apolonia ka armën që tashmë e njohin të gjithë: Gërxhon, me "raketat" e tij të "telekomand-uara". Nga një goditje e lirë prej 40 metrash, kapiteni fierak barazon katër minuta pas golit të Arifajt. Më pas, shënon një tjetër kryevepër, me një goditje të harkuar

Pas ndeshjes

Artan Mergjyshi (trajner i Dinamos): "Besuam deri në fund te fitorja, por nuk ishim të qartë për të shfrytëzuar rastet. Pësuam dy gola të evitueshëm, ndërsa në sulm gabuam shumë me lojë individuale dhe goditje të pasakta. Tani ka vetëm një shpresë, që pikët e humbura me Apoloninë t'i marrim me Skënderbeun".

Dhimitër Papuçiu (trajner i Apolonisë): "Ne dëshironim fitoren, megjithatë është një pikë që vlen. Na afroi më tepër me Tomorin dhe sidomos na ka dhënë më tepër moral. Kjo është një skuadër e rindërtuar nga e para, ndërkohë që ishim me dhjetë lojtarë. Megjithëse luftohej për mbijetesë, ishte lojë shumë korrekte dhe skuadra tregoi se ka perspektivë".

pothuajse nga flamuri i këndit. Në të dy golat, portieri Osmani është "bashkautor", duke pasur pjesën e tij të fajit. Blutë megjithatë kanë meritën që nuk çoroditen dhe e gjejnë shumë shpejt barazimin, falë penalltisë së fituar nga Shtini dhe të shndërruar në gol nga Kuli. Bashkë me gjuajtjen nga pika e bardhë vjen edhe kartoni i dytë i Muçajt dhe Apolonia mbetet me dhjetë lojtarë. Dinamo është skuadra që synon më tepër drejt portës kundërshtarë dhe rastet nuk i mungojnë, por manovra blu nuk funksionon deri në fund, pasi gjuajtjet janë të pasakta. Fillimi i pjesës së dytë është më i mirë dhe Apolonia ngjshet e gjitha në mbrojtje. Duket e pashpresë, por e sjell në jetë një mrekulli e Ramës. Sulmuesi shpërthen nga e djathta, driblon çdo kundërshtar, në zonë i lirohet edhe Kajës dhe pastaj gjuan saktë, ngjitur me shtyllën nga e djathta e Osmanit. 3-2 për Apoloninë, e cila është në inferioritet numerik, ndërkohë që edhe balanca e gjykimit anon më tepër nga blutë, ndonëse pa e bërë "baltë" si në shumë fusha të tjera kur favorizohen vendasit. Mergjyshi fut Imamin dhe Dajën, të cilët i japin më tepër gjallëri lojës. Dinamo nuk ka ç'të humbasë dhe sulmon

me të gjitha forcat. Goli i barazimit vjen në minutën e 61-të, sërish me Arifajn, i treti për të në këtë kampionat. Ka kohë të mjaftueshme për të fituar dhe Dinamo sulmon. Apolonia mbrohet me të gjitha forcat dhe sidomos në ajër nuk lejon rreziqe. Shtini gjuan përherë në duart e portierit, Kuli jashtë, ndërsa Djarmati ndalet nga shtylla. Fizikisht Dinamo e përballon më mirë terrenin e rënduar, por e lodhur është mendja dhe aksionet nuk kanë logjikë. Forca e dëshpërimit përplaslet në murin e qetësisë së fierakëve, të cilët në fund i kënaqen barazimit. I janë afruar me një pikë Tomorit dhe me Ramën e rikthyer mund të shpresojnë. Dinamo është pothuajse në zi, me një "këmbë" në Kategorinë Inferiore.

Golat

13' Kuli krosin në zonë nga një goditje e lirë, Arifaj merr topin pranë portës pasi mbrojtësit fierakë nuk arrijnë të pastrojnë zonën, gjuan saktë dhe mposht Xhixhën, **1-0**.

17' Gërxho ekzekuton një goditje të lirë nga 40 metra. Topi përplaslet në tokë dhe Osmani vetëm sa e prek me krahun e djathtë, pa mundur ta devijojë, **1-1**.

31' Gërxho ekzekuton bukur një goditje të lirë nga e majta, Osmani grushton dhe e nxjerr jashtë, pranë trekëndëshit. Gërxho krosin nga këndi, topi rikthehet tek ai dhe në pozicion krejtësisht të prirët kapiteni i Apolonisë harkon mbi Osmanin, duke tundur për herë të dytë rrjetën, me një gol fantastik, **1-2**.

34' Kuli krosin për Shtinin, i cili tërhiqet nga Muçaj, duke iu mohuar goditje me kokë. Peza sinjalizon për 11-metërs dhe kartonin e dytë të verdhë për lojtarin e Apolonisë. Gjuan Kuli nga e majta e Xhixhos, i cili kupton krahun por nuk mund ta kapë topin që kalon vijën fatale ngjitur me shtyllën dhe **2-2**.

51' Rama merr topin nga e djathta dhe me një aksion personal driblon të gjithë mbrojtësit që i dalin përpara, hyn në zonë dhe gjuan saktë ngjitur me shtyllën e kundërt, duke mposhtur për të tretën herë Osmanin, **2-3**.

61' Aksion i gjatë i Dinamos, i cili mbyllet me gjuajtjen e Arifajt, nga 18 metra larg portës. Topi shkon rrafsh me tokën dhe hyn në rrjetë ngjitur me shtyllën nga e majta e Xhixhës, **3-3**.

Episodet

4' Shtini hyn në zonë nga e majta, gjuan jashtë.

8' Grami pason prapa te Kaja, por topin e rrëmben Rama që del përballë Osmanit dhe gjuan drejt e në duart e portierit.

19' Tri gjuajtje radhazi të Dinamos, fillimisht me Bilibashin e Arifajn, pastaj Djarmati, që e kalon topin mbi tra.

23' Pas krosimit nga këndi, Grami gjuan brenda zonës me të djathtë, por topi përplaslet në shpinën e Kajës, i cili shpëton portën fierake.

35' Krosim në zonën fierake, Ribaj tërhiqet nga një mbrojtës dhe rrezohet, por Peza refuzon kërkesën e fierakëve për penallti.

44' Shtini brenda zonës gjuan drejt portierit.

45' Kaja gjuan me kokë pas krosimit nga këndi, mbi tra.

47' Krosim i Gramit nga e majta, Kuli zhytet e gjuan me kokë, krejt i lirë, mbi tra.

65' Djarmati gjuan brenda zonës, topi përplaslet në shtyllë.

73' Kuli gjuan në pozicion ballor, pret mirë Xhixha.

84' Kuli lirohet pranë portës nga e majta, gjuan dhe topi del jashtë ngjitur me shtyllën e largët.

85' Xhixho grushton gjuajtjen e Shtinit, më pas edhe atë të Arifajt, pastaj Malota me kokë dhe topi del jashtë, pasi përplaslet në trupin e Ibrahim.

Numra pikantë...

■ Numër të njëjtë golash sa dhe starti i fazës së parë (21 gola) pati dhe starti i 7 ndeshjeve të fazës së dytë. Më tepër se gjysma (12) e golave të javës XIV u përqendrua në dy ndeshje. Te fitorja pardje në transfertë 4-2 e Skënderbeut në Berat dhe barazimi me "festival" golash dje i Dinamos më Apoloninë në Tiranë.

■ Nuk ka të sosur numri i rekordeve negative të Dinamos në këto 14 javë. Ka realizuar vetëm 7 gola me mesataren tepër të ulët 0.50 për ndeshje. Nuk ka ende një fitore dhe bashkë me Apoloninë e Tomorin janë ekipet me numrin më të madh të humbjeve (secila nga 9).

■ Kishte ndodhur për herë të fundit që prej javës së 10-të diferenca me plus 2 pikë e Teutës kryesuese ndaj Tiranës që e ndjek nga pas. Por nga fitorja direkte e bardhebluve në premierën e kësaj jave 2-1 në Durrës përfituan jo pak për t'u afruar dhe Skënderbeu e Flamurtari që i fituan ndeshjet e tyre në transfertë, respektivisht korçarët ndaj beratasve dhe vlonjatët ndaj Kamzës debutuese.

■ Me 11-metërsin që shënoi në Berat, Ble-

di Shkëmbi ka tani 4 penallti të realizuara. Afrohet kapiteni korçar me goleadorin peqinas Roland Dervishi që ka realizuar ndër 11 golat e tij që e mbajnë atë akoma në krye të listës së "snajperëve", 5 prej golave nëpërmjet finalizimeve të sakta nga pika e bardhë.

■ Në raport me 14 javët e fazës së parë të kampionatit të kaluar ku ishin shënuar 183 gola, tani shifra e shënimit ka tregues mjaft pozitivë. Konkretisht janë shënuar 246 gola gjithsej, pra 63 gola më shumë. Edhe mesatarja totale duket e kënaqshme momentalisht me 2.51 gola për çdo ndeshje në këtë kampionat aktual.

■ Barazimi 3-3 është i dyti që arrihet në këto 14 javë. Kishte ndodhur dhe në ndeshjen e javës së VIII në Shkodër Vllaznia - Bylisi rezultati spektakolar si dje në Tiranë, në Dinamo-Apolonia, rezultat që ka përkeqësuar mjaft shanset për mbijetesë të skuadrës kryeqytetase që ashtu sikurse Tirana janë të vetmet ekupe të futbollit elitare shqiptar që nuk e kanë provuar asnjëherë rënien në një kategori më poshtë.

Përgatiti: FATMIREFICA

KATEGORIA SUPERIORE

Rezultatet e javës XIV	
Teuta-Tirana	1-2
Çota 45'/Bala 12', Stafa (a) 55'	
Laçi-Vllaznia	1-0
Hysa 5'	
Kamza-Flamurtari	0-1
/Selimi 82'	
Shkumbini-Bylis	1-1
Mustafai 50'/Xhon 44'	
Tomori-Skënderbeu	2-4
Baku 34', Çarls 61'/Shkëmbi 10' (p), Radas 41', Çarls 61', Muzaka 66', Muzaka 70'	
Pogradeci-Kastrioti	1-1
Çerepi 45' (p)/ Ognjatoviç 83'	
Dinamo-Apolonia	3-3
Arifaj 13, 61', Kuli 34' (p) / Gërxho 17', 31', Rama 51'	

Renditja	
1. Teuta	14
2. Tirana	14
3. Skënderbeu	14
4. Flamurtari	14
4. Kastrioti	14
6. Bylis	14
7. Shkumbini	14
8. Vllaznia	14
9. Laçi	14
10. Kamza	14
11. Pogradeci	14
12. Tomori	14
13. Apolonia	14
14. Dinamo	14

Moti i keq dhe me lagështirë në ditët e fundit në qytetin e Lushnjës ka përkeqësuar akoma më shumë, gjendjen e fushës së stadiumit "Roza Haxhiu". Për momentin fusha e lojës duket shumë keq dhe jashtë mundësive për ndeshje zyrtare. Po kështu edhe terreni stërvitor pranë stadiumit "Roza Haxhiu" ka vetëm ujë dhe baltë. Ndaj shtyrja e veprimtarive futbollistike, më shumë se për ndonjë moment relaksi për skuadrën, është mirëpritur

Lushnja, Sefa do "pak të thatë"

për t'i dhënë kohën e domosdoshme terreneve që të "marrin veten".

Post-Mamurrasi - Sulmuesi Fatjon Sefa ishte padyshim futbollisti më i mirë për verdhëjeshilët në transfertën e Mamurrasit. Falë fizikut të mirë ka "çarë" ujin e baltën, duke dhënë një rendiment të jashtëzakonshëm në lojë. Është përjekur të shërbejë për Can-

Sulmuesi, falë fizikut të tij, ka qenë edhe në Mamurras një pikë referimi për skuadrën e Malkos, por terreni atje dhe kushtet e stërvitjes në Lushnjë e kanë lodhur. Dhe jo vetëm fizikisht...

kën, por, të shënojë edhe vetë. Në fund, shifrat janë 0-0. "Lamë dy pikë shumë të rëndësishme në një ndeshje që e meritonim ta fitonim. Në përgjithësi kemi luajtur mirë, ndonëse ekipi duhet të kishte më shumë grintë. Barazimi na ka trishtuar, sepse krijuam shumë episode para portës. Nuk patëm fat në goditjen finale dhe mendoj që nuk po thye-

jmë atë "tersin" që po na shoqëron në humbjen e rasteve", u shpreh sulmuesi lushnjar, Fatjon Sefa.

Ndërprerja - Të luash ndeshjen hapëse dhe më pas të pushosh, nuk është një gjë e mirë. Por, moti i keq ka bërë "kërdinë" dhe pushimi duket i detyruar. Sulmuesi shtatlathtë i Lushnjës ka një formë të mirë, të treguar edhe në përgatitoret e

dimrit. "Terrenet ku punojmë dhe stërvitemi janë shumë të këqija dhe natyrisht që na pengojnë që të bëjmë lojën tonë. Në këto kushte punojmë dhe përpiqemi të bëjmë më të mirën. Tani mendojmë të evitojmë barazimet dhe të fitojmë ndeshjet e ardhshme. Kemi zhvilluar vetëm një ndeshje nga kjo fazë, dhe e dimë mirë se, janë fitoret ato që do të na mbajnë në krye të tabelës", u shpreh sulmuesi i verdhëjeshilëve.

ALBAN ALUSHI

Magani "fërkon duart", shtyrja "sjell" 3 titullarë

Besa-Trepçe '89 Mitrovicë 0-0

Besa: Mançevski, Fejzullahu, G.Krasniqi, Hoxha, Perja, Frashëri, Mihani, Poçi, Duka, Ziambo, Dushku. **Tr:** G.Magani

U aktivizuan dhe: Bakaj, Tosuni, Tragaj, Dedej, Hasa, Duro, Çelhaka, Mehmeti

Trepçe: Manxholli, Misini, Ahmeti, Izmaku, Kukaj, Nallbani, Ambe, F.Krasniqi, Hyseni, Rexha, Musaj. **Tr:** R.Prekazi

U aktivizuan dhe: Baliqi, Shala, Peçi

Gjyqtarë: I.Munishi (Kosovë), Xh. Demni, M.Dauti (Kavajë)

Miqësorja e dytë brenda një jave me Trepçen (nga e hëna, në të hënë), nga 3-0 për Besën, më 6 shkurt, dje është mbyllur pa gola, 0-0. Ka qenë një ndeshje shumë e bukur e mjaft interesante për nga rivaliteti, madje edhe me situata emocionuese. Del në pah kjo edhe ngaqë portierët e të dy skuadrave kanë qenë ata që janë prezantuar mjaft mirë dhe nuk kanë lejuar gola në portat e tyre, respektivisht Mançevski e Bakaj te Besa dhe Manxholli të Trepçe. Në krahasim me një javë më

parë janë përdorur më pak ndërrime futbollistësh. Te Besa ka rënë në sy një paraqitje e mirë që ka bërë sulmuesi January Ziambo, i cili lëvizti mjaft e dha shumë pasime të bukura e madje në dy-tre momente ka kërkuar të shënojë vetë, por portieri kosovar ka qenë i pamposhtur. Ndërsa për ekipin mik, ka qenë Berat Hyseni ai që goditi në një rast shtyllën dhe shkaktoi "drithërima" te porta kavajase.

Besa, me përjashtim të 10 minutave të para kur u

BESA/
Luhet një tjetër miqësore me Trepçen. Pas stërlodhjes nga udhëtimi në Ersekë, kavajasit e mbyllin pa gola



Magani

desh më tepër kohë seç duhej që të orientohej nga stërmundimi i Ersekës, gjatë gjithë pjesës tjetër të takimit kërkoi të dominonte. Mesfusha me Poçin e Mihanin nxiti manovrën sulmuese, por Dushku, Ziambo e Hasa nuk ishin në gjendje të finalizonin edhe pse në pozicione ideale me portën.

Te Besa janë në "dorën e fundit" të rikuperimit pas dëmtimeve mesfushori Paulin Dhëmbi, qendërm-

brojtësi Alban Dragusha dhe sulmuesi Daniel Rroshi, që pritet t'i bashkohen grupit nga sot. Duke qenë se kampionati për shkak të kushteve atmosferike tepër të rënduara është shtyrë, kavajasit pritet të zhvillojnë dhe ndonjë miqësore tjetër me ekipet nga Kosova, si Liria e Prizrenit, Drita e Gjilanit, apo Drenica e Skënderajt, që janë aktualisht duke kryer fazën përgatitore në Golem. **FATMIR EFICA**

Kukësi: Ata nuk janë rastësisht në majë

Skuadra e Berberit e ka nisur mbarë 2012-n, mbetet -3 ndaj Luftëtarit kryesues

Një takim problematik - flitet në planin e organizimit - mund të konsiderohet Kukësi-Butrinti. Nisi me dëborën e jashtëzakonshme që "pushtoi" qytetin verilindor, vijoi me përpjekjet e stërmundimshme për të pastruar terrenin, u intensifikua përmes debatesh të shumta dhe "shtegtoi" në Laç, të hënë, ku "gjeti derman" për t'u luajtur. Sidoqoftë, lodhja nervore dhe pritshmëria e kuksianëve u shpërblyen përmes asaj fitoreje që, edhe pse minimale, konsolidoi edhe më tej pozicionin nr. 2 në tabelën e renditjes. Mesfushori i Kukësit, Thana, shprehet: "Ndeshja me sarandiotët pati në vetvete gjithçka të panjohur e gjithçka sillej rreth motit e dimrit në veri, por ishin kushtet natyrore tepër të ashpra në Kukës ato që diktuan shtyrjen e më pas ndryshimin e vend-zhvillimit të saj. Para se të hyj në aspektin teknik, dua të them se në të tilla raste nevojitet mirëkuptimi mes palëve. Dhe ne arritëm ta luajmë ndeshjen, falë gjuhës së përbashkët me ekipin e Butrintit. Qëndruam të dy ekipet në Shëngjin dhe thuajse në të njëjtën kohë u nisëm për në Laç për ta luajtur atje ndeshjen. Edhe për këtë, ndjemë detyrimin të falënderojmë drejtuesit e Laçit që na hapën portat e stadiumit të tyre. E them këtë pasi të gjithë e dinë me sa kujdes e trajtojnë në Laç impiantin në tërësi dhe fushën në veçanti".

Duke "kaluar" te ndeshja, Thana shton: "Arritëm një fitore me shumë vlera, madje mund ta quajmë edhe vendimtare. Dueli ynë përgjithësisht ishte i bukur dhe rivalizues, por ne kishim një futbollist më shumë: tifozët tanë që kishin ardhur për të na ndjekur edhe në Laç. Pa e tepruar mund të pohoj se, në pjesën më të madhe e komanduan ne takimin. Gjithsesi edhe Butrinti, me futbollistë të rinj, shfaqti në fushën e lojës përgatitje për t'u admiruar. Ata zhvilluan një garë të pëlqyeshme që ne nuk e kishim menduar të tillë. Sidoqoftë, ne fituam me meritë".

Në këtë përbashkësi, trajneri Berberi provoi për të parën herë në formacionin bazë edhe futbollistë të ardhur nga merkatoja e janarit: Allamanin, Hamzain, Lenën dhe Memishin. "Me atë që dhanë në fushë, shpresoj të jenë të dobishëm për skuadrën tonë", analizon Thana, "natyrisht nëse do ta meritojnë besimin e trajnerit. Pozitiv është fakti se edhe pse distanca me Luftëtarin mbetet e njëjtë, ajo me ndjekësit e tjerë, për shkak të frenimit në barazime të tyre, është rritur. Dhe kjo na bën të ndjehemi mirë", ka mbyllur mesfushori.

ZYLFI TOLA

Butrinti s'e "harron" kalendarin

Nuk ka patur aspak kohë për t'u çlodhur e për të pushuar. Qysh dje, me t'u kthyer nga Laçi, ka nisur java e re stërvitore për sarandiotët. Kështu do të kishte ndodhur edhe po të ndaheshin me barazimin e shpresuar nga takimi me Kukësin, ndërsa mosprekja e këtij synimi, e ka bërë edhe më të ngutshme dhe të domosdoshme stërvitjen, pa humbur as orën. Sigurisht që nuk ka qenë e lehtë të kalohet nga lodhja në lodhje. Aq më tepër që kjo transfertë ka qenë raskapitëse, pasi është udhëtuar drejt Kukësit e pastaj drejt Laçit. Por askush prej futbollistëve nuk ka munguar as nga seanca e parë e javës së re stërvitore. Është kjo arsyeja që njoftimi për shtyrje të kampionatit nuk është mirëpritur në Sarandë, edhe pse teknikisht mund të ketë nevojë të riformatohen elementë të lojës e formacionit. Pritet që edhe trajneri Gurma "të grisë" planin javor e t'i kthehet ndonjë cikli të ri stërvitor. Sidoqoftë, askujt nuk i lejohet të harrojë se në kalendar ata do të presin Mamurrasit. Një skuadër, kjo e fundit, që ka ditur të ndalojë vullin e lushnjarëve. Por që në Sarandë duhet të provojë "shije" tjetër.

NIKO THOMA

RENDITJA PAS JAVËS XV

	N	F	B	H	GOL.	PIKË
1. LUFTËTARI	15	12	1	2	27-9	37
2. KUKËSI	15	11	1	3	22-8	34
3. LUSHNJA	16	9	4	3	23-9	31
4. BESËLIDHJA	16	9	4	3	17-7	31
5. BESA	15	8	3	4	23-16	27
6. ELBASANI	16	8	1	7	26-26	25
7. GRAMSHI	16	6	4	6	22-23	22
8. ADA	15	5	5	5	19-16	20
9. MAMURRASI	16	5	4	7	15-23	19
10. BUTRINTI	16	5	3	8	18-19	18
11. GRAMOZI	15	5	2	8	11-19	17
12. ILIRIA	16	5	1	10	18-24	16
13. VLORA	16	4	3	9	15-23	15
14. SKRAPARI	16	3	6	7	13-21	15
15. BURRELI	15	4	2	9	10-25	14
16. HIMARA	16	2	4	10	13-24	10

Pas ndeshjes

Gugash Magani (trajner i Besës): "Ishte një ndeshje shumë e bukur e mjaft serioze. Ne kemi vuajtur mungesën e duhur të rikuperimit të futbollistëve nga stërlodhja që patëm nga udhëtimi Kavajë-Ersekë, ndonëse ndeshja jonë në kampionat nuk u luajt. Kemi ndërkohë nga futbollistët e formacionit bazë, lojtarë që janë në fundin e ciklit të riaftësimin të tyre si Dragusha, Poçi e Dhëmbi. Shtyrja e kampionatit na jep gjithë kohën e duhur të stabilizimit të të gjithë treguesve sportivë, duke e pritur ndeshjen e radhës me Adën e Velipojëj sa më të përgatitur dhe më synimin e vetëm, arritjen e pikëve maksimale".

Rafet Prekazi (trajner i Trepçes): "Sërish, shumë falënderime për Besën e stafin e saj drejtues. Kemi luajtur me këtë ekip dy ndeshje mjaft të mira. Në këtë fazë, Trepçe duket se po përmirësohet ndjeshëm dhe do të jemi në fazën e dytë pretendente për titullin kampion në Kosovë, pasi dhe diferencën me dy ekipet sipër nesh nuk e kemi të madhe në pikë. Skuadra në këtë miqësore ka funksionuar edhe më mirë dhe jemi në rrugën e duhur gjatë kësaj faze përgatitjesh që po zhvillojmë këtu në Shqipëri".

Ekipi i futbollit bluzi dhe trajneri Nevil Dede, e nisën mbarë konkurrimin e fazës së dytë. Përballë një kundërshtari, i cili ndodhet në vendin e 13-të në renditje, Vlora, loja e bluzinjve ka kënaqur trajnerin Dede, i cili në "premierën" e tij zyrtare, që kur ka marrë drejtimin e Luftëtarit, paraqiti një formacion luftarak, me shpirt gare dhe një lojë sulmuese, e cila nuk u kushtëzua nga fakti se fillimisht ishin bluzinjtë në disavantazh.

Në vlerësimin e tij të parë, pak përpara nisjes së seancës së parë stërvitore të kësaj jave, Dede shprehet: "I rëndësishëm për ne ishte realizimi i fitores. Futbollistët reagues mjaft mirë pas disavantazhit. Ishte ndeshja e parë zyrtare që unë drejtova, vazhdon prononcimin e tij për "Sport Ekspres", trajneri i bluzinjve, Dede, dhe jam shumë i kënaqur nga kondicioni fizik që treguan futbollistët. Kjo, falë edhe përgatitjeve dimërore shumë serioze që kemi zhvilluar. Sigurisht, ka emri vend për përmirësim dhe këtë do të bëjmë në ditët në vazhdim, deri sa të rinisë përsëri gara".

Si një mbrojtës me shumë cilësi, gjatë viteve që ka luajtur në fushën e blertë, Dede e ka "merak" momentin që Luftëtari pësoi gol: "Mënyra se si pësuam golin, thekson ai, erdhi si rrjedhojë e një momenti mospërqendrimi. Të tilla gabime nuk duhet të përsëriten, sepse ekipi vihet përballë situatash

LUFTËTARI

"Harron" fitoren e Vlorës, Dede e ka me mbrojtjen: S' duhej të pësonim gol!

Në takimin e parë zyrtar, trajneri kryeqytetas ka triumfuar në transfertën me "Djemtë e birrës": "Skuadra diti të reagojë si duhet, edhe pse u ndodh në disavantazh"

të paparashikuara. Por, jam i kënaqur nga impenjimi i gjithë grupit, i cili si një "grusht i vetëm", në minutat në vazhdim, ndryshoi gjithçka në favorin e tij. Ky është një aspekt shumë i rëndësishëm, sepse tregoi besimin që ka grupi brenda vetes".

Edhe pse trajneri Dede është shumë i kënaqur nga futbollistët e aktivizuar, përsëri nuk dëshiron të përmendë emra të veçantë, të cilët bënë diferencën. "Nuk e kam zakon dhe nuk është në filozofinë time, të përmend emra të veçantë, shprehet Dede, kur shikoj dëshirën e madhe të të gjithë futbollistëve në fushën e lojës. Për mua, futboli është lojë kolektive dhe përgjegjësitë duhen marrë nga të gjithë, ashtu siç u veprua në fitoren kundër Vlorës".



Nevil Dede

Në minutat e para të përballjes Vlora-Luftëtari u dëmtua golshënuesi më i mirë, jo vetëm i Luftëtarit, por edhe i Kampionatit të Kategorisë së Parë, Nora. Ky ishte një moment preokupues për kreun e stolit bluzi. Gjë që vazhdon edhe në momentin kur Dede jep prononcimin për gazetën. "Pas dëmtimit të Norës, ne humbëm forcën kryesore në lojën ofensive. Ky fakt ishte shqetësues. Do të jetë kështu deri sa ai të rikuperohet. Por, duke qenë se gara është shtyrë, ky është një moment i mirë për të rikuperuar, jo vetëm Norën, por edhe Brahon e Ramadanin. Me rikthimin e tyre, grupi plotësohet më së miri dhe konkurrenca do të na bëjë mirë", mbyll prononcimin, kreu i stolit të ekipit të futbollit bluzi, Nevil Dede.

PIRRO QIQI

Qirjako: S'i druheni askujt, ne do të jemi në gjashtëshe!

GRAMOZI/ Vendi i 11-të dhe 17 pikët e grumbulluara, skuadra kolonjare është tetë pikë nga vendi i gjashtë, që mbahet nga Elbasani

Skuadra kolonjare është e gatshme të përballojë sfidat e fazës së dytë të kampionatit. Përgatitjet e fundit, edhe pse në kushte atmosferike jo të mira, po tregojnë se kolonjarët janë të vendosur për të qenë në gjashtëshen e parë. Në të njëjtën linjë me djemtë është edhe vetë trajneri me përvojë, Ilir Qirjako i cili gjatë një deklaratë për "Sport Ekspres" thekson se nuk i druhet rivalëve. "Për momentin ndodhemi në vendin e 11-të me 17 pikë, dhe një ndeshje më pak, me skuadrën e Besës, e cila nuk u zhvillua ditën e shtunë për shkak të kushteve atmosferike. Por, skuadra ime do të jetë shumë shpejt në gjashtëshen e parë të renditjes. Edhe pse rivalët tanë janë përforcuar mjaft, kjo nuk na tremb. Ne jemi përgatitur me shpirt gjatë kësaj periudhe dhe vetëm për këtë qëllim. Objektivi ynë mbetet i pandryshueshëm: qenien në zonën që të mundëson kjalimin në Superiore".

Trjneri e di mirë se, që të ngjitesh atje lart, nuk mjaftojnë fjalët: "Për të marrë rezultate pozitive, duhet të tregohemi me autoritet brenda dhe jashtë fushës", nis të vërë piketat Qirjako. "Çdo futbollist duhet të ndihmojë shokun edhe kur gabon dhe jo të shkarkojë përgjegjësitë nga vetja, pasi futboli është një lojë kolektive. Futbollistët duhet të mbajnë edhe një regjim të rreptë edhe në jetën private, pasi çdo abuzim që mund të bëjnë do të kompromentonte edhe rendimentin e tyre në fushë".

Dhe pas kësaj nuk mungojë fjalët motivuese: "Ne jemi një skuadër që kemi treguar vlera në shumë takime të zhvilluar. Ky pozicion në renditje nuk është ai që i takon Gramozit, pavarësisht nga luhatjet e shfaqura. Motoja jonë tashmë është grumbullimi i pikëve të domosdoshme, për t'u ngjitur më lart. Nuk duhet gabuar, sidomos me rivalët. Kemi pasur mundësi që gjatë ditëve të fundit të bëjmë ndonjë ndryshim në përbërje. Qëllimi ynë është për të rregulluar repartin e mesfushës dhe sulmit, atje ku ka qenë edhe pika e jonë e dobët e skuadrës, pas largimit të pesë lojtarëve titullarë, dhe megjithatë, ne tashmë e kemi të afuar edhe futbollistin sulmues".

Porta-Përsa i përket portës, pozitiv është fakti se korçari Bello, që kish pësuar një dëmtim në dorën e djathtë, tashmë ka filluar stërvitjen me grupin, dhe brenda dy javësh shpresohet që të arrihet më e mira e tij. Kështu që trajnerit Qirjako i ka ardhur për shtat kjo shtyrje e kampionatit, pasi mund të jetë i përfituari i momentit ose edhe për t'u vënë në garë në kushte të barabarta me gjithë ekipet e tjera, edhe përse i përket mundësisë për një proces stërvitor të plotë. Nga ana tjetër, kjo shtyrje i jep mundësinë trajnerit dhe disa futbollistëve që nuk kanë kryer një fazë të plotë përgatitore të arrijnë tek ajo që pritet edhe në aspektin fizik.

ALBERT ALIKO

File në Gramsh, një transfertë më afër se kaq!

Elbasani ka shansin që më në fund të ketë sukses në një ndeshje jashtë shtëpisë

Verdheblutë janë afuar dy pikë me rivalen më të afërt, Besën, e cila mban edhe vendin e pestë në klasifikim, një pozicion që të jep mundësinë për të luajtur një përballje direkte me një skuadër të Superligës. Megjithatë, duhet thënë se kavajasi kanë një ndeshje më pak dhe nëse e kalojnë me sukses provën e vështirë që kanë me Gramozin, atëherë elbasanasit do të shkonin sërish në -5. Por, për momentin një gjë e tillë nuk po mendohet nga kampi verdheblu, pasi duan t'i gëzohen faktit se tani janë shumë afër vendit që të jep shpresën e ringjites në Superiore.

Fitorja e fundit ndaj Skraparit në "Ruzhdi Bizhuta" ka treguar se Elbasani i ka potencialet e duhura për t'ia dalë mbanë në këtë kampionat. Ajo që është më e rëndësishme ka të bëjë me vazhdimësinë edhe në përballjet e tjera, sidomos ato jashtë fushe, ku dihet se skuadrën e drejtuar nga File e kap "ngërçi" sa herë del nga qyteti.

Parë kështu, shpresa te verdhe-



Mustafaraj, me dinjitet para "Lalës së Madh"

GRAMSHI/ Derbi është tema e ditës në mbarë opinionin futbolldashës të qytetit

Tashmë që ndeshja me Ilirinë ka kaluar, përveçse kënaqësisë që ka lënë shija e fitores, ka mbetur dhe një fushë të baltosur që kërkon që të vihet dorë në të sa më parë. Dhe duke qenë se ndërhyrjet në këtë periudhë janë krejt të pamundura, së paku të mos dreqoset përfundimisht. Nisur nga këto kushte, edhe ekipi i futbollit, në pamundësi që stërvitja të zhvillohet në terren të hapur, ka preferuar pallatin e sportit ku ushtrimet me top në hapësira të vogla kanë qenë dominuese.

Nga mënyra se si rodhën ngjarjet, duket e hershme të flitet për ndeshjen e radhës, atë me Elbasdanin. Por, meqë kemi të bëjmë me një derbi - gramshiotët e kanë edhe për mburrje - tema e diskutimeve s'mund të shmanget nga një përballje e tillë. Për më tepër, Gramshi i këtij kampionati ka treguar se është një skuadër që të detyron ta respektosh.



"Sigurisht që është një takim kyç - ka thënë tekniku i Gramshit, Mustafaraj - Është një derbi prefekturë që nuk mund të shmanget, pasi të dy ekipet kanë nevojën për pikët maksimale në këtë ndeshje. Elbasani për të pretenduar edhe më lart dhe Gramshi me dinjitetin që po tregon, kërkon që të afirmojë edhe më shumë veten e tij".

Fansat gramshiotë që e kanë vlerësuar në maksimum ekipin e tyre lidhur me atë çka dhanë ndaj Ilirisë, kërkojnë një impenjim maksimal edhe ndaj ekipit të Elbasanit. Ndërkohë që pyetja lind natyrshëm se, a është në gjendje ekipi i Gramshit të përballojë Elbasanin që ka qenë në kohën më të madhe kontigjent i superiores? Fansat besojnë se, po!

Sidoqoftë, statistikat tregojnë se skuadra elbasanase ka dominuar, pasi për gramshiotët siglohet vetëm një barazim 0-0. SOTIRAQ ZIU

blutë është rritur, ngaqë skuadra nuk do të lëvizë shumë kilometra, ndërsa ndeshjen e radhës do të luajë në Gramsh. Në shtesë të kësaj kujtohet se në takimin e fazës së parë, verdheblutë shënuan pesë herë në portën e tyre, duke marrë edhe fitoren e parë në këtë kampionat. E njëjta gjë do të tentohet sërish me skuadrën e Mustafarajit që më në fund të arrihet sërish fitorja e parë... kësaj here në transfertë! Sigurisht, verdheblutë nuk mund të pretendojnë të fitojnë me të njëjtat shifra, pasi në këto kushte mund të duket si diçka e pamundur, por do t'u mjaftonte edhe një gjysmë goli për të sigluar tri pikët, që mund të quheshin ndryshe edhe pikët e shpresës. Diferenca e vetme me rivalët, që i ka lënë edhe me pikë mbrapa elbasanasit, janë fitoret e munguara jashtë shtëpisë së vet. Është momenti i duhur, duke parë edhe përforsimet që bënë në këtë merkato të shkurtër të dimrit, për të bërë kthesën e shumëpritur.

FATMIR POPJA

Atletika shqiptare është në zi, ndërsa ka humbur një nga figurat më të mëdha të saj si Kastriot Sulçe. Në mënyrë të papritur, teksa deri dje e kanë patur mes tyre, miqtë e shokët, por dhe sportistët, që vetë i rriti, tronditen nga lajmi i kobshëm se ka humbur jetën Kastriot Sulçe. Një infarkt e ka ndarë nga kjo jetë 53-vjeçar, të cilin miqtë i patën vënë nofkën "Mëzi". "Kastriot Sulçe, atletit kampion të jetës, që dëshmoi madhështinë e talentit dhe karakterin e jashtëzakonshëm, që nuk u mposht nga asnjë stuhi e kohës". Vetëm rreth dhjetë muaj më parë, Kupa "Nderi i Figurave" pati marrë emrin e Kastriot Sulçes, me të cilin presidenti i Federatës Shqiptare të Atletikës, Gjergji Ruli, Sekretari i Përgjithshëm, Nikolin Dionisi, Mjeshtëri i Merituar i Sportit, Sokol Morina, apo dhe trajnerja e atletikës, Liljan Gjerazi (Karanhxa) jo pak kanë pozuar. Fotografi që të paktën sot do t'ua ruajnë të gjallë kujtimin e Kastriot Sulçes, të cilin nuk e kanë më mes tyre.

Cili është Kastriot Sulçe?

Kastriot Sulçe, ka lindur më 6 gusht 1959. Në karrierën e tij ka garuar për 17

Atletika shqiptare në zi
Kastriot Sulçe, talenti që nuk u mposht nga stuhitë e kohës

Nëntorin dhe Skënderbeun, ndërsa ka qenë Kampion dhe rekordmen në garat e shpejtësisë 100, 200 dhe 400 metra, si dhe 100 metra me pengesa. Mjeshtëri i Sportit që në fëmijëri pati dëshirën dhe talentin për t'u shkruar me sportin e atletikës, aq sa edhe kur ishte i internuar dhe i dënuar me punë të rëndë, të vraponte. Në moshën 13-vjeçare, në vitin 1972, Sulçe filloi karrierën në klubin 17 Nëntori (Tirana e sotme), ku trajneri i tij i parë ishte Shaban Lame. Menjëherë ra në sy talenti i tij në garat e shpejtësisë, teksa në vitin 1973 u shpall Kampion Kombëtar për moshat 15-16 vjeçare. Një vit më vonë, më 1974, Sulçe arriti të shpallej kampion i të rinjve, ndërsa kohët e tij (në 400 metra, 54'08", dhe në 800 metra 2'02"), ishin tepër premtuese. Garën e



parë për të rritur, Sulçe e zhvilloi në moshën 16-vjeçare. Po këtë vit, më 1975, Kastriot Sulçe zhvilloi dhe garën e parë ndërkombëtare ndaj ekipit kinez, ku sërish kohë e arritura të tij ishin tepër mbresëlënëse. Në vitin 1977, në moshën 18-vjeçare, erdhi dhe shpërthimi i mjeshtërit. Në 100 metra, ai dha kohën 10"8, ndërsa vazhonte ta rriste formën e tij. Po në këtë vit, Sulçe arrin të fitojë njëkohësisht garat e 100 m dhe 1000 metra, teksa bëhet atleti i parë shqiptar që i fiton këto gara. 15 qershor 1977 është dita më e errët e jetës së tij. Regjimi i atëhershëm e internon, megjithatë vetëm një ditë para internimit, me dëshirën e madhe për të vrapuar për "herë të fundit", fiton garën e 100 metrave në të cilin ishin të gjithë sprinterët më të mirë të asaj kohe për Shqipërinë. Megjith-

atë Sulçe edhe në internim vazhdoi stërvitjen individuale, teksa ishte i ndaluar të stërvitej në stadium. Në vitin 1981-1982 u detyrua të shkojë ushtar dhe, megjithëse ishte kampion i vendit, nuk lejohet të stërvitej. Por me dëshirën dhe vullnetin, që nuk i mungonte, vazhdoi vetë përgatitjet. U dënua sërish nga regjimi i asokohe me 6 muaj punë të rëndë në tunel, pasi "kishte vrapuar pa leje". Pas burgut, Sulçe nuk u la në ekipet e kryeqytetit, por shkoi në Korçë, teksa konkurroi për Skënderbeun. Në vitin 1983, pas 5 muajsh stërvitje individuale, theu dy rekorde kombëtare; në 200 metra dha rezultatin 21"6 dhe në 400 metra 48"2. Po më 1983, Sulçe u shpall kampion në garat e vjeshtës. Më 1984 dhe 1985 u shpall dy herë radhazi kampion kombëtar. Shumë rekorde e trofe, të cilat bëjnë që emri i Kastriot Sulçes të mbetet në pedestalin e "Mbretëreshës së Sporteve". Në Korçë, pasi la karrierën si sportist, ka ushtruar dhe rolin e trajnerit, duke nxjerrë disa breza atletësh aktualë. Dhe për të gjithë sa ka dhënë Kastriot Sulçe në atletikën shqiptare është më tepër se sa një humbje. **Gj.V.**

Khudo

Majlinda Kelmendi, si favorite në Europeanin e Sheljabinsk të Rosisë

Pasi ka arritur normën e kualifikimit për në Lojërat Olimpikë "Londër 2012", xhudistja kosovare, që do të përfaqësojë Shqipërinë, ka të drejtë të përzgjedhë turnetë

Një ndër të kualifikuarit në Shqipërisë në Lojërat Olimpikë "Londër 2012", është edhe xhudistja Majlinda Kelmendi. Kosovarka e peshës 52 kg në fakt nuk ka arritur më shumë se sa një fitore europiane. Por aktualisht, për shkak dhe të rezultateve të larta në turnetë ndërkombëtarë, së fundmi ka dy vende të pesta në Kupën e Botës në Almati të Kazakistanit, ajo është në vendet e larta të renditjes botërore. Në të gjitha aktivitetet e saj, kjo xhudiste numëron 15 medalje ari, 6 medalje argjendi dhe 8 medalje bronxi. Dhe për rrjedhojë, në Kampionatin Europian, i cili do të mbahet në Sheliabinsk të Rosisë, më 26-28 prill, ajo hyn si favorite.

Deri në Europeanin në Rusi do të mbahen edhe disa turne të xhudos, ndërsa Kelmendi do të marrë pjesë vetëm në njërin prej tyre. Ajo nuk mund të humbasë më shumë se një vend në renditjen botërore dhe, për këtë arsye, ka vendosur që më shumë t'ua kushtojë rëndësi përgatitjeve sesa pjesëmarrjeve në gara. Kelmendi tashmë ka siguruar normën



për pjesëmarrje në Lojërat Olimpikë "Londër 2012". Kjo i mundëson që të përzgjedhë turnetë se ku do të paraqitet. Kësisoj një provë e madhe për të përpara Lojërave Olimpikë "Londër 2012" është Kampionati Europian në Rusi, ku të gjithë presin që ajo të mos jetë më poshtë se vendi i pestë, pozicion të cilin deri më tani e ka marrë në Almati të Kazakistanit dhe në Paris të Francës.

GJERGJ VYSHKA

Shumësportësh

Ngjitje alpinistike nga Shpiragu në Tomor për 100-vjetorin e Pavarësisë

100-vjetori i shpalljes së Pavarësisë do të festohet dhe në Berat dhe, krahas aktiviteteve të tjera, do të ketë dhe veprimtari sportive të cilat do të jenë në disa lloje disiplinash. Por kjo ide nuk duket se është e Bashkisë së Beratit, apo dhe e klubit shumësportësh. Janë vetë trajnerët, të cilët në institucionet ku punojnë, u kanë kërkuar drejtuesve që të planifikojnë veprimtari sportive. Rasti më konkret është trajneri i alpinizmit, Vullnet Zylyftari, i cili i ka kërkuar Kryetarit të Këshillit të Qarkut Berat, Petrit Sinaj, që të financojë aktivitetet sportive për 100-vjetorin e Pavarësisë. Pavarësisht se mund të jetë aktivitet lokal, për nga shtrirja me disa kilometra në vendin ku do të zhvillohet, ai mund të cilësohet kombëtar. Dhe duke shfrytëzuar raportet mjaft të mira me drejtuesin më të lartë të Këshillit të Qarkut Berat, si dhe dashamirësinë e shprehur prej tij për të ndihmuar dhe financuar aktivitetet sportive, trajneri i Tomorit në alpinizëm, Vullnet Zylyftari, ka paraqitur dhe një projekt ambicioz. Sinaj ka kryer të gjitha veprimet konkrete, ndërsa së bashku me sektorin e financës ka bërë dhe një preventiv. Në lidhje me këtë aktivitet, trajneri i Tomorit në alpinizëm, Vullnet Zylyftari, do të deklaronte: "Sporti i alpinizmit në qytetin tonë, krahas shumë aktiviteteve të hartuara nga ana e Federatës, ka projektuar edhe një aktivitet lokal me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë. Një veprimtari, e cila do të jetë e përmasave kombëtare për vetë shtrirjen e tij gjeografike. Fillimisht, do të jetë një ekspeditë e specializuar me 50 sportistë profesionistë dhe amatorë nga më të spikaturit. Do të startojmë një ngjitje alpinistike malore, që do të ketë startin e saj në malin e Shpiragut, pikërisht në Komunën e Sinjës, aty ku dhe është bërë Kuvendi i madh historik i kësaj zone. Më pas do të vijojë në Tendën e Qypit dhe nga Përmeti do të kalojë në Çorovodë, më konkretisht në Kanionet e Osumit, për të përfunduar në vendet historike në malin e Tomorit. Një aktivitet që do të nisë me 50 alpinistë, por që kulmin do ta ketë në fund, teksa do të bashkohen qindra nxënës në majën e Tomorit. Më duhet të them se ky projekt mjaft ambicioz s' do të kishte aspak kuptim pa mbështetjen e madhe morale dhe financiare të Këshillit të Qarkut Berat dhe të kryetarit të saj, Petrit Sinaj, të cilin gjej rastin ta falënderoj". **EDI SPAHIU**

Boks/ Xhulio Vrenozi, tre javë përgatitje në Kardif

Xhulio Vrenozi mund të jetë boksieri i vetëm shqiptar i cili do të mund të arrijë normën e kualifikimit në Lojërat Olimpikë "Londër 2012". Dhe për këtë qëllim, falë bashkëpunimit mes Federatës Shqiptare të Boksit dhe asaj të Anglisë, Vrenozi dje është nisur për tre javë në Kardif të Uellsit. I shoqëruar nga trajneri shkodran, Jozef Sermi, Vrenozi do të stërvitet për tre javë në këtë qendër stërvitore, duke patur një bashkëpunim të ngushtë me boksierët britanikë. Sipas Federatës Shqiptare të Boksit, në këtë vajtje të Vrenozit në Kardif të Uellsit ka patur dhe një lidhje të ngushtë me Federatën Botërore të Boksit Amator, e cila ka

mundësuar bashkëpunimin me britanikët. Shansi i Vrenozit është turneu i fundit kualifikues për në "Londër 2012" në Turqi, ndërsa nga Kardif do të kthehet më 10 mars. "Nuk do të marrë pjesë në "Memorial Shkodra 2012", - saktëson inspektori i Federatës Shqiptare të Boksit, Migen Pero, - sepse në kohën që kthehet ai nga Kardif ka nisur aktiviteti. Nëse arrin të kualifikohet për në "Londër 2012", Vrenozi do të mund të shkojë dhe tre javë të tjera për stërvitje në këtë qendër". Dhe në fakt, është hera e parë që boksier shqiptar dërgon një sportist për një përgatitje më të kualifikuar përpara Lojërave Olimpikë "Londër 2012". **Gj.V.**

Boks Profesionist
Nebi Ademi, Kampion Europe, tani do dhe një titull Botëror

Nebi Ademi, të shtunën në mbrëmje, në ringun zviceran të Bernës, është shpallur Kampion Europe në versionin WFC. Ai ka fituar ndaj boshnjakut Senan Haxhiç, teksa e ka mundur me KO Teknik në raundin e dytë. Ademi, të paktën dhe sipas faqes zyrtare në internet "www.kosovaboxing.com", tregoi sërish se mund të matet me më të mirët. Dhe gjithçka është vërtetuar në raundin e dytë, ndërsa pas një serie goditjesh e ka hedhur poshtë boshnjakun Haxhiç. Kjo fitore, Ademit mund t'i rikthejë sërish mundësinë për të dyluftuar për titullin Kampion Bote në versionin WFC. **Gj.V.**



Australiani i Red Bullit përgënjeshton zërat për tërheqjen në fund të sezonit 2012 nga Formula 1

Ueber: S'jam ende për "pension"!

"E di që Red Bulli ka pilotë të rinj shumë të mirë si Vernje e Rikiardo, por unë nuk kam mbaruar"

Sezoni ndoshta nuk ka nisur ende, por që tani Mark Ueber përballet me të njëjtat pyetje mbi të ardhmen e tij te Red Bulli, që zunë vendin kryesor edhe në pjesën e dytë të 2011-s. Ueber, që nuk ka thënë kurrë se kur do të tërhiqet, u shpreh për gazetën australiane "Sunday Age" se nuk ka vendosur të tërhiqet në fund të sezonit 2012 pasi mezi po pret të sfidojë rivalët e tij në këtë Botëror. "Nuk është aspak e vërtetë që do të tërhiqem në fund të 2012-s", tha Mark. "Kam përjetuar shumë e shumë gjëra në pistë dhe jashtë saj dhe e di shumë mirë që asgjë nuk vazhdon përjetësisht. Para katër vitesh të gjitha mediat pretendonin se unë do të zëvendësohesha tek Red Bulli nga Kimi Raikonen, por ja që kjo nuk ndodhi". Por Ueber pranoi se gjërat nuk kishin shkuar shumë mirë në sezonin 2011. "Po, ishte një start i vështirë i sezonit dhe më pas gjërat shkuan pak edhe për inerci në atë drejtim", vazhdoi Ueber. "Megjithatë, mendoj se edhe këto janë mësimë për mua, pavarësisht se në moshën time dhe me përvojën që kam në këtë sport

askush nuk beson se kam ende për të mësuar". Por Ueber pretendon se pas pushimeve dimërore ndihet i rifreskuar dhe i gatshëm për të nisur këtë sfidë të re. "Ky ka qenë një dimër vërtet i këndshëm, sepse më në fund nuk bëra asgjë, por vetëm pushim", tha australiani. "Kjo më lejoi të karikoj bateritë siç duhet për një sezon tepër të ashpër si ky. Me impenjimet që kam me Red Bullin por edhe ato personale, dimrat e kaluar kanë qenë shumë të zënë për mua, por sivjet e ndava mendjen dhe nuk bëra asgjë që të më



lodhte sërish pas përfundimit të sezonit. E di që sivjet beteja në kampionat do të jetë shumë e ashpër, sepse këto rregulla të reja duket se e kanë ekuilibruar konkurrencën dhe mbase edhe Lotusi është afuar me ne, por unë jam gati për sfidën. Dhe nëse e fitoj këtë sfidë, nuk kam pse largohem nga Red Bulli dhe pse skuadra jonë ka një program shumë të mirë zbulimi talentesh dhe yje të rinj si Vernje dhe Rikiardo mezi presin të kenë shansin e tyre në skuadrën kryesore, pasi do të bëjnë një sezon me Toro Roson".

MotoGP

Stoner: Rregullat po na dëmtojnë

Kejsi Stoner kritikoi ashpër një ndryshim në rregulloren e MotoGP që detyroi skuadrën e tij, Honda, të shtonte 4 kilogram në motorin e saj të ri 1000-kubikësh për sezonin 2012, pasi sipas kampionit të Botës në fuqi futja e vonshme e kësaj risie ka sjellë probleme të mëdha për Hondën në kthesa. Stoner, që ishte gjysmë sekonde më i shpejtë se rivalët në testimet e para të 2012-s, javën e kaluar në Sepang, Malajzi, tha se motori Honda 1000cc ishte zhvilluar me një "peshë specifike në mendje" dhe ndryshimi i vonshëm i kësaj solli probleme. "Ne e kishim zhvilluar motorin dhe më pas Federata mori vendimin për ndry-

"Federata gaboi që shtoi 4 kg në çastin e fundit. Motorët nuk janë "Ok" në kthesa"

shimin e peshës minimale", tha australiani. "Kjo influencën jo pak në sjelljen e motorit në pistë. Nuk duket shumë në kushte normale pilotimi, por për fat të keq ndihet shumë nëpër kthesa, sidomos në mesin e tyre, që është edhe pika më kritike për motorët në një garë. Sigurisht, rregullat janë të njëjta për të gjithë dhe ne do të përshtatemi gjatë kohës së mbetur për prova, por nuk më pëlqen që rregullat të ndryshohen në çastin e fundit, pasi të gjithë kanë derdhur shumë djersë për zhvillimin e motorit".

NBA

Rondo heroik, Bostoni thyen Çikagon

Organizatori i Selltikshënon një tripël-dopio, duke fituar duelin e superfuqive

Rajon Rondo hakmarret pas paraqitjes së dobët ndaj Torontos dhe kritikave të pësuar nga trajneri i tij, Dok Rivers. Organizatori i Selltiksave ngarkoi mbi shpinë sulmin e Bostonit, realizoi një tripël-dopio (32 pikë, 15 asist e 10 topa në tabelë) dhe udhëhoqi Bostonin në fitoren e duelit të superfuqive të Lindjes ndaj Çikago Bullsave. "Demat" nuk kanë në fushën e lojës, yllin e tyre,

Derrick Rouz, sërish për shkak të telasheve me shpinën, dhe në mungesë të organizatorit kryesor nuk arrijnë të përballojnë ritmin frenetik të Rondos. Ata tentojnë të rikuperojnë disavantazhin prej 14-pikësh në pesë minutat e fundit të takimit, por kur shkojnë deri në -3, është gjithnjë Rajon që mbyll çdo llogari me sfidën. Nga humbja e Çikagos përfitoi Majemi që, duke fituar me lehtësi ndaj Atlantës, u afua me "Demat" në duelin personal për kreun e Konferencës së Lindjes.

Ndeshjet e djeshme

Boston-Çikago	95-91	Golden Steit-Hjuston	106-97
Atlanta-Majemi	87-107	Memfis-Jutah	88-98
Detroit-Uashington	77-98	Toronto-LALejkërs	92-94

PER BURRIN QË S'DUHET TË KERKOJË... KURRE

Distributor zyrtar për Shqipërinë TILUX sh.p.k
Adresa: Rr.Mine Peza
1/4/28 Tiranë
Tel: 04 2239733
Tel/Fax: 04 2239839
Cel: 0682033481
E-mail: tlf@abcom-al.com



Faza e 1/8-ve/ **Ndalohe gabimet, tani momenti i së vërtetës për tetë çifte**



Mesi



Ronaldo



Drogba



Ibra



Roben

“Gjuetia” ndaj kampionëve në fuqi, Barcelonës, më e hapur se kurrë

Pas dy muajsh pushim, rinis gara më e bukur për klube, Champions League, e cila ka mbërritur në një fazë delikate, ajo ku nëse del jashtë “dyerve të Europës”, nuk mund të kthehesh më. Ajo kur edhe gabimi më i vogël vendos, jo më kot Hoze Murinjo, njeriu që e ka fituar dy herë me dy skuadra të ndryshme, e ka quajtur “kompeticioni i fatit dhe detajeve”. Kupa me “veshë të mëdha”, do të rinisë sot, me kampionët në fuqi, Barcelonën, që do të udhëtojë në Gjermani, për provën “Leverkusen” dhe me surprizën më të papritur, APOEL i Nikosisë, qipriotët që përfaqësojnë modelin shembullor të një klubi që edhe me 1/8 e investimeve të “big”-ëve ka arritur të kapërcejë vështirësitë dhe sot do të ndeshet me ekipin e traditës në këtë turne, Olimpik Lionin, që në kampionat nuk po ecën mirë, por në Europë mund të tregojë vlerat. E kështu me rradhë, në formatin e ri, do të zhvillohen edhe përballjet e tjera, javë pas javë, derisa të eliminohen gjysmat dhe të vazhdojnë fazat e tjera. Ëndrra e të gjithëve quhet “Allianz Arena”, stadiumi i Bajernit, në Mynih, aty ku dëshirat mund të bëhen realitet. Më 19 maj, të gjithë do të duan të jenë aty, por vetëm dy ekipe do të jenë dhe njëra do të shpallet kampion.

Hapet “gjuetia”- “Gjuetia” për Leo Mesin dhe Barcelonën e mrekullive (që kohët e fundit ka shfaqur pika të dobëta), mund të quhet e hapur. Për gjermanët e Bajern Leverkusenit parashikimi duket i mbyllur që në start, pasi të mendosh që të elimi-

RINIS ËNDRRA

16 skuadra dhe rruga drejt “Allianz Arena”

Real, Bajern, Çelsi, Milan & Co do të përpiqen të pengojnë arritjen e katalanasve, që në rast suksesi do të thyenin rekordin e formatit Champions, duke e fituar dy herë radhazi



nosh Kampionët e Botës së Barcelonës duket me të vërtetë e pamundur, edhe pse “asnjëherë mos thuj kurrë!”.

Ligjet e TV - Ashtu si ndodh thujse gjithmonë prej disa sezonesh, për të kënaqur nevojat e televizioneve, që kanë pushtetin absolut ekonomik, faza me eliminim direkt sheh në

program vetëm dy ndeshje në ditë. Pra, një mundësi kjo për tifozët, por sidomos për televizionet, që përfitojnë më shumë. Mjafton të mendosh që vitin e shkuar nga shpërndarja e të drejtave xhiruan shifra mbi 200 mln euro.

Të tjerat- Të mërkurën do të jetë radha e duelit Itali-Angli, gjithmonë e

më i ndezur. Milan-Arsenal është sfida e sfidave, por kuqezinjët nisen me një “handikap” të tmerrshëm, pasi janë eliminuar gjithmonë nga britanikët në këto edicionet e fundit (Arsenal, Mançester, Totenham). S’duhet lënë pas dore edhe Zeniti ndaj Benfikës, një sfidë që premtion spektakël. Rusët mund të

Programi i fazës së 1/8-ve

Sot
Lion-APOEL ora 20:45
Leverkusen-Barcelona ora 20:45
(kthimi, 7 mars 2012)

Nesër
Milan-Arsenal ora 20:45
Zenit-Benfika ora 20:45
(kthimi, 6 mars 2012)

21 shkurt 2012
Napoli-Çelsi ora 20:45
CSKA-Real Madrid ora 20:45
(kthimi, 14 mars 2012)

22 shkurt 2012
Bazel-Bajern M. ora 20:45
Marsejë-Inter ora 20:45
(kthimi, 13 mars 2012)

Bastet/ Katalanasit superfavoritë

Lion (50.00) - APOEL (150.00)
Napoli (30.00) - Çelsi (12.00)
Milan (25.00) - Arsenal (20.00)
Bazel (250.00) - Bajern Mynih (6.00)
Leverkusen (150.00) - Barcelona (2.50)
CSKA M. (250.00) - Real Madrid (3.75)
Zenit (100.00) - Benfika (50.00)
Marsejë (150.00) - Inter (25.00)
(në kllapa, koeficienti i suksesit final)

Golashënuesit

“Vigani-shkurtabiqi”, mes Gomezit dhe Mesit dueli i golave ndizet më shumë

6 gola: Gomez (Bajern Mynih), Mesi (Barcelona)
5 gola: Dumbia (CSKA Moskë), Frei (Bazel), Gomis (Lion), Soldado (Valencia)
4 gola: Kajehon (Real Madrid), Pedro (Barcelona), Ibrahimoviç (Milan), Benzema (Real Madrid), Kavani (Napoli), Hulk (Porto)

paguajnë përgatitjen jo të mirë, si pasojë e “pauzës” së gjatë për dimrin e ashpër.

Pas një javë-Javën e ardhshme do të jetë radha e Real Madridit të Murinjos për të treguar vlerat ndaj “Ushtrisë së kuqe” të Moskës, CSKA. Ndërsa, Napoli, në krizë rezultatesh në Itali, do të ketë përballë Çelsin, që gjithashtu po vu-


an në Angli. Por, Europa përfaqëson për të dyja atë “gomone shpëtimi”. E kompletojnë programin Bazel-Bajern Mynih dhe Marsejë-Inter, me zikaltërit që do të tentojnë të kalojnë, për t’i dhënë një kuptim sezonit. Ndërsa, për Bajernin, mund të jetë sezoni i së vërtetës, pasi finalja luhet në “Allianz”.

Leverkusen - Barcelona (sot, ora 20:45)

Trajneri i Barcelonës, Pep Guardiola, u shfaq në konferencën për shtyp në prag të ndeshjes së parë ndaj Bajer Leverkusenit duke kërkuar maksimumin nga skuadra e tij. Katalanasit po kalojnë një moment të vështirë, por 41-vjeçari është i bindur se Barcelona e tij do të luftojë deri në fund për të fituar Champions League e dytë radhazi, diçka që nuk e ka bërë më parë asnjë skuadër. “Nuk mërzitem për faktin që kemi gabuar shumë në kampionat. Të fitosh 13 trofe nga 16 të mundshëm do të thotë se kjo Barcelonë nuk dorëzohet kurrë. Njerëzit mendojnë se me kampionatin pothuajse të përfunduar, tani do të fitojmë Champions-in. Dhe nëse nuk e fitojmë, atëherë do të jetë një dështim. Nuk e kuptoj këtë. Objektivi ynë është që të luftojmë. Ky Champions është shumë i vështirë dhe gjithçka mund të ndodhë. Na kërkojnë që të fitojmë të gjashtë trofe, diçka që vetëm ne e kemi bërë në 2009-n. Askush nuk e ka përsëritur suksesin në Europë për dy vite me radhë, megjithatë ne do të tentojmë”. Lidhur me ndeshjen e sotme, Guardiola tha: “Shqetësimi im primar është që ta njoh sa më mirë Leverkusenin. Janë më të fortë se ne nëse nuk kemi zotërimin e topit. Duhet të bëjmë kujdes nga kundërsulmi i tyre dhe nga goditjet standarde. Nëse nuk kemi kontrollin e ndeshjes, atëherë mund të na ndëshkojnë. Do të mundohemi të shënojmë të paktën një gol”.

Guardiola: Gati të fitojmë një tjetër Champions!

Formacionet e mundshme



Trajneri katalanas flet për sfidën e sotme: “Edhe nëse nuk triumfojmë, nuk do të ishte zhgënjim. Leverkuseni? Janë të rrezikshëm në kundërsulm”



Pep Guardiola

FOTOLAJM

Pike bën aksident me makinë

Xherard Pike është përfshirë në një aksident automobilistik. Futbollisti spanjoll u godit nga një tjetër automjet në rrugët e Barcelonës, teksa po shkonte për t'iu bashkuar skuadrës në udhëtimin drejt Gjermanisë. Fatmirësisht, lojtari nuk ka pësuar asnjë dëmtim

Rruga e dy skuadrave

GRUPI E		GRUPI H	
Çelsi-Leverkusen	2-0	Barcelona-Milan	2-2
Leverkusen-Genk	2-0	BATE B.-Barcelona	0-5
Leverkusen-Valencia	2-1	Barcelona-Plzen	2-0
Valencia-Leverkusen	3-1	Plzen-Barcelona	0-4
Leverkusen-Çelsi	2-1	Milan-Barcelona	2-3
Genk-Leverkusen	1-1	Barcelona-Bate B.	4-0
Renditja		Renditja	
1.Çelsi	11	1.Barcelona	16
2.Leverkusen	10	2.Milan	9
3.Valencia	8	3.Plzen	5
4.Genk	3	4.BATE B.	4

Kuriozitetet dhe precedentet rreth sfidës

- Skuadra gjermane, Bajer Leverkusen i ka fituar të gjitha ndeshjet në shtëpinë e saj në fazën e grupeve, por këtë herë do të luajë kundër Barcelonës, e cila ka një mesatare prej 4 golash të shënuar në transfertë.
- Leverkusen nuk kishte luajtur kurrë më parë kundër një skuadre spanjolle, përpara ndeshjes kundër Barcelonës në çerekfinale të Kupës UEFA në sezonin 1987-88, sfidë të cilën e ka fituar Milton Tita ka shënuar golin në ndeshjen e kthimit të “Camp Nou” duke shënuar nga Andoni Zubizarreta. Në finale, skuadra gjermane ka fituar sërish ndaj një skuadre spanjolle, kundër Espanjolit.
- Të dyja skuadrat kanë fituar 2-1 kur janë përballur në fazën e grupeve të Champions League në 2001-'02. Në atë ndeshje luanin Mikael Balak nga njëra anë, ndërkohë që Karles Pujol dhe Ksavi Hernandes nga krahu tjetër.
- Barcelona ka fituar 2-1 në Leverkusen dhe 2-0 në shtëpinë e saj, në fazën e dytë të grupit të sezonit 2002-'03. Pujol, Ksavi dhe Iniesta kanë qenë në fushë për skuadrën spanjolle.

Balak nuk luan kundër katalanasve


Bajer Leverkusen do të jetë pa shërbimet e mesfushorit Mikael Balak për ndeshjen e sotme kundër Barcelonës. Ish-kapiteni i Gjermanisë ka pësuar një dëmtim muskular në stërvitje dhe u desh që ta braktisë atë për t'iu nënshtruar trajtimit mjekësor. Ai do të ishte një shtyllë e fortë për vendasit në ndeshjen e parë që luhet në “Bay Arena”, ndërsa nuk dihet ende saktësisht, se për sa kohë do të jetë i padisponueshëm 35-vjeçari. Balak u la në stol në humbjen 1-0 të Leverkuseni, ndaj udhëheqësve të Borussia Dortmund në Bundesligë, të shtunën. Gjithashtu, për skuadrën gjermane në dyshim janë edhe Sidnei Sam dhe Eren Derdiok për shkak dëmtimesh.

Lion - Apoel (sot, ora 20:45)

Trajneri i Apoel Nikozisë, Jovanović, është shumë i lumtur për arritjen që ka bërë ekipi i tij deri në këto momente. Skuadra qipriote ka arritur të kualifikohet në fazën e 1/16 dhe sot do të luajë kundër Lionit.

Jovanović kërkon të zgjasë mrekullinë qipriote

- Nëse në fillim të sezonit do t'ju kishin thënë që do të shkonit në këtë fazë të Championsit, çfarë do të kishit menduar?
- Do të kisha thënë që e ekzagjerojnë. Do të kisha thënë që do të ishte e mrekullueshme.
- Si e keni festuar këtë arritje?
- Në fillim nuk isha shumë i sigurt që do të mund fitonim me kundërshtarë të fortë. Por kur kemi fituar kundër Zenitit dhe Shakhtarit kemi kup-



tuar se mund të kualifikoheshim. Mbase do ta kuptojmë në një të ardhme atë çfarë kemi bërë.

- Po kundër Lionit, cili është shqetësimi juaj më i madh?
- Eksperienca e Lionit është shumë e madhe. Ata kanë cilësi dhe janë në formë të mirë. Nuk duhet të bëjmë ndonjë gabim për t'iu nënvlerësuar.
- Me çfarë “arme” do ta vendosni në vështirësi Lionin?
- Nuk duhet të bëjmë gabime në mesfushë, pasi Lionit është një skuadër e jashtëzakonshme në atë repart.



Rruga e dy skuadrave

GRUPI D		GRUPI G	
Ajaks-Lion	0-0	Apoel-Zenit	2-1
Lion-Dinamo Z.	2-0	Shakhtar D.-Apoel	1-1
Real M.-Lion	4-0	Porto-Apoel	1-1
Lion-Real M.	0-2	Apoel-Porto	2-1
Lion-Ajaks	0-0	Zenit-Apoel	0-0
Dinamo Z.-Lion	1-7	Apoel-Shakhtar D.	0-2
Renditja		Renditja	
1.Real Madrid	18	1.Apoel	9
2.Lion	8	2.Zenit	9
3.Ajaks	8	3.Porto	8
4.Dinamo Z.	0	4.Shakhtar D.	5

Nesër, Milan-Arsenal (ora 20:45)



Goli i uellsianit me "Topçinjtë", thujse gjithmonë, sjell humbjen "VIP": Bin Laden, Stiv Xhobs, Gedafi dhe Uitni Hjuston "viktimit" e fundit në radhë

Rastësia e çuditshme

Sa herë që Ramsi e dërgon topin në rrjetë, vdes një... personalitet

Tifozët e futbollit kanë bërë një lidhje të çuditshme mes yllit të Arsenalit, Aron Ramsi dhe vdekjes së këngëtares, Uitni Hjuston. Sa herë që mesfushori gjen rrugë e rrjetës, një figurë e famshme botërore humb jetën dhe ylli i muzikës pop ishte personazhi i katërt brenda vitit të fundit. Trupi i saj i pajetë u gjet në dhomën e hotelit vetëm pak orë pasi 21-vjeçari i kishte shënuar gol Sandërlendit në ndeshjen e të shtunës. Por koincidenat kanë filluar në majin e vitit të kaluar, kur Ramsi shënoi përballë Mançester Junajtedit. Të nesërmen, terroristi ndërkombëtar, lideri i Al-Kaedas, Osama Bin

Laden, u vra nga trupat amerikane. Në tetor, ai shënoi përballë Totenhamit, ndërsa vetëm tre ditë më vonë, u nda nga jeta themelues i "Apple", Stiv Xhobs. Më vonë, në të njëjtin muaj, ai shënoi përballë Marsejës në Ligën e Kampionëve. Të nesërmen, diktatori libian Muhamar Gedafi u qëllua për vdekje nga protestuesit. Në forumet e klubit anglez tashmë ka filluar një diskutim "mistik" rreth kësaj çështje. "Jam i shqetësuar se mos situata del nga kontrolli nëse ai shënon me më shumë rregullsi", ishte komenti humoristik i një prej tifozëve të "Topçinjve". Në "San Siro" do të kryqëzohen gishtat...



Bin Laden



Uitni Hjuston

"DEZERTORËT" E "CAMP NOU"

Ibra kundër Henrisë, nga titulli katalanas, te sfida në "San Siro"!

Takimi i së mërkurës mes Milanit dhe Arsenalit në San Siro do të jetë mbi të gjitha një duel mes Zlatan Ibrahimoviç dhe Thierry Henry, të cilët 2 ditë përpara sfidës vendosën të flasin. Francezi, i cili pas ndeshjes do të largohet nga Arsenalit duket tepër i karikuar duke deklaruar se nuk ka menduar për momentin e ikjes, pasi është fokusuar më shumë te ajo që do të japë në fushë përballë Milanit, pasi Milani mbetet Milan. "Në "San Siro" është tepër e vështirë të fitosh dhe kjo dihet, ndaj duhet të bëjmë kujdes ndaj kuqezinjve. A do të kthehem një ditë te Arsenalit? Nuk i dihet, edhe pse zemra më thotë "po". Nëse do të më duan. Ndeshja ime e fundit? Ndodhën të gjitha kaq shpejt, nuk e prisja". Sfidat është tepër delikate dhe mbi të gjitha përballë kuqezinjve nuk ka qenë asnjëherë e thjeshtë të fitosh sidomos në transfertë në Champions League. Henri në vitin 2003 ishte protagonist me një dopietë në atë 5-1 që Arsenalit regjistroi përballë Interit dhe sigurisht që shpreson të përsërisë të njëjtën performancë edhe përpara se ti thotë "lamtumirë" ekipit

Zlatan dhe Titi fituan Ligën dhe Superkupën me Barcelonën, në sezonin 2009-2010, duke u larguar më pas respektivisht te Milani dhe në Amerikë. Për francezin është sfida e lamtumirës, pasi do të kthehet te LA Galaksi

Ibra: "Champions-i nuk është një fiksim për mua dhe nëse nuk e fitoj s'do të shkul flokët. Më mjaftojnë ato që kam arritur, por i kam arritur sepse kam luajtur në ekipet më të mira"

Henri: "Milani është Milan dhe të fitosh në "San Siro" është shumë e vështirë, ndaj duhet të ruhemi dhe të kemi kujdes. A do të kthehem te Arsenalit një ditë? Nëse do të më duan"

të tij. Ibrahimoviç, nga ana tjetër, provon ta ulë disitensionin duke thënë se vite më parë për suedezin "Champions" ishte objektiv primar, por kur dicka e dëshiron aq shumë dhe e hiperbolizon, ndodh që nuk e fiton asnjëherë. Fut-

bollisti kuqezi u shpreh se nëse fiton, është mirë, por edhe në të kundërt nuk do e përjetojë shumë pasi e rëndësishme është të japë maksimumin në fushë. "Champions nuk është më një fiksim për mua, sepse edhe nëse do ta mbyll karrierën pa e fituar s'do të shkul flokët, pasi kam arritur gjithçka që doja, duke u bërë edhe më i miri. Por, fati im ka qenë që kam luajtur në skuadra numër 1, sepse nuk mjafton të jesh më i miri që të fitosh, por të luash te më të mirët".

Dikur shokë... - Ish-te sezoni 2009-2010 kur Barcelona vendosi të hiqte Samuel Eto'onë dhe, pasi Reali zyrtarizoi Ronaldon e Kakanë, bëri investimin gjigant prej 80 mln eurosh për të marrë Zlatan Ibrahimoviçin (Eto'onë dhe 50 mln euro). Ishte Barcelona që ëndërronte për Champions, por që nuk e fitoi. Megjithatë, Zlatani e ndihmoi të fitonte titullin dhe Superkupën e Spanjës. Bashkë me Ibrën, në atë Barcelonë, luante edhe Tierry Henri. Të dy kishin një raport të shkëlqyer me njëri-tjetrin dhe, në fund të sezonit, u larguan, njëri drejt Italisë, Milanit, tjetri drejt Amerikës, Los Anxhelos Galaksi. Sot, në Milano, do të ndeshen.



Henri (m) dhe Ibra kur iuanin me Barcelonën

Kuqezinjtë kanë një "llogari për të larë"!

Eliminimi i fundit ende "djeg" te Milani, edhe pse "Topçinjtë" kanë pësuar ndryshime radikale nga ajo kohë. "Tabuja" angleze tremb, pasi në tre vitet e fundit, kuqezinjtë janë eliminuar nga tri britanike: Mançester, Arsenal, Totenham

Futbolli është një sport i përbërë nga tradita për të kthyer dhe hakmarrje. Milani kundër Arsenalit, do të mundohet që të prishë një "tabu" kundër skuadrave angleze, që në tre edicionet e fundit në Champions League, e kanë eliminuar Milanin. "Kemi mundësinë për të marrë hak-

marrjen tonë", është shprehur drejtori organizativ i Milanit, Umberto Gandini. Por Milani do të hakmerret me Arsenalin, por edhe me skuadrat angleze, të cilat që nga sezonin 2007-'08 dominon në sfidët e Champions League me eliminim direkt. Në atë sezon skuadra e drejtuar nga Ançeloti, është eliminuar nga Arsenalit. Në 2009-'10, Mançester Junajtid e poshtëroi skuadrën e Leonardos, duke fituar si në "San Siro" ashtu edhe në "Old Trafford". Mallkimi vazhdoi edhe në sezonin e fundit, ku ekipi i Alegrit është eliminuar nga Totenhami. Kështu pra kundër Arsenalit do të jetë një mundësi e mirë për të thyer këtë "tabu".

Boateng e Nesta në fushë, Pato mund të... "kursehet"!

Alegri s'do të rrezikojë me brazilianin, pasi kthehet pas një tjetër dëmtimi të gjatë, ndaj preferon ta ruajë për sfidën-titull ndaj Juves; "Faraoni" në moment fantastik, mund të propozohet me Ibrën në sulm

Trajneri i Milanit, Masimiliano Alegri, ka marrë disa lajme premtuese nga stafi mjekësor para takimit të Ligës së Kampionëve ndaj Arsenalit. Aleksandre Pato, Kevin Princ Boateng dhe Alesandro Nesta janë kthyer në stërvitje. Pato u lëndua në takimin ndaj Novaras në Kupë në muajin janar, Boateng lëndoi muskulin në derbin ndaj Interit, ndërsa Nesta u lëndua në stërvitje para takimit ndaj Napolit. Sidoqoftë, Milani ka konfirmuar përmes faqes zyr-

tare se të tre lojtarët i kanë kaluar problemet e tyre dhe do të jenë në dispozicion në takimin e të mërkurës në "San Siro". Por, përpara se të përkthejë Patos, situata është disi e ndërlikuar, sepse temperaturat jo të mira mund të rrezikojnë jo pak shëndetin e lëkundur dhe formën fizike jo 100% të brazilianit, ndaj ai mund të "konservohet" për sfidën titull të 25 shkurtit, ndaj Juventusit, në kampionat.

"Faraoni" - Megjithatë, Alegri po mendon për Stefan El Sharauin në sulm, të mbështetur nga Ibra. Sigurisht, është edhe Robinjo e Maksi Lopez, por teknikut kuqezi i ka pëlqyer jo pak freskia e formës së "Faraonit", që edhe ndaj Udinezes shënoi një gol vendimtar, ashtu si në fazën e parë. Mesatarja e 20-vjeçarit, në fakt, është më e lartë se Pato në vitin e tij të parë kuqezi, ndaj në rast se do të vazhdojë kështu, mund të thyjë edhe rekordin e tij në Milanelo. Megjithatë, duhet parë se si do të paraqitet në vazhdim dhe, nëse Alegri do t'i besojë sërish, tani që kthehen të dëmtuarit në sulm.



0
Erjon Bogdani nuk ka zhvilluar ende asnjë ndeshje me Sienën. Dje, duhet të shkonte të paktën në stol, ndaj Romës, por kështu nuk ka qenë

Toti dhe Kalaio (d) gjatë Siena-Roma 1-0

Kishte kërkuar "kthesën" Valter Maxarri dhe, më në fund, e mori atë, sepse Napoli i tij kthehet të fitojë pas disa ndeshjesh, duke mundur mbrëmë Kievon, që këto vitet e fundit kishte qenë "mace e zezë" për axurrët. Ka mjaftuar pjesa e parë për të futur në "kasa-fortë" rezultatin dhe tri pikët. Një mbrëmje magjike sidomos për blerjen e verës, Britos, që nuk mundi të luante fazën e parë për shkak të një dëmtimi të gjatë. Mbrojtësi realizoi me kokë golin e avantazhit. Në të 38' ishte Kavani ai që dyfishoi

Napoli kthehet të fitojë; Siena "stopon" Romën!

Axurrët zgjidhin gjithçka në pjesën e parë, me golin e Britosit dhe të Kavanit, nga 11-të metërshi. Në "Franchi", skuadra e Enrikes mundet nga penalltia e Kalaio dhe mbetet mbrapa në renditje

nga pika e bardhë e penalltisë, pas faullit të portierit Sorrentino ndaj uruguanit. Por, për t'u dalluar ka qenë gjesti i Aronikës ndaj Paloskit, pasi e goditi lojtarin e Kievos me shuplakë, gjatë një dyluftimi, por gjyqtari nuk pa. Ky epi-

sod mund t'i kalojë provës televizive. Në pjesën e dytë axurrët administruan dhe Maxhio iu afrua golit të tretë. Ndërkaq, në Siena, Roma ka pësuar një humbje që ndërlikon jo pak objektivat për zonën Champions. Djemtë e Enrikes kanë

hasur rezistencën e fortë toscane dhe u ndëshkuan në fillim të pjesës së dytë nga Kalaio, me 11-të metërsh, pas faullit në zonë të Kjaerit ndaj po të njëjtit Kalaio. Reagimi i verdhekuqtë ishte i zbehtë dhe Siena ruajti tri pikët.

Tre humbje në katër ndeshje, bëjnë që skuadra zikaltër të "rrëshqasë" në krizë

NË HUMNERË Numrat "kryqëzojnë" Interin!

Me tre humbje në katër ndeshjet e para të fazës së dytë, Interi ka vendosur në vështirësi të madhe pozicionin për Champions League në sezonin e ardhshëm. Skuadra e Claudio Ranierit ka marrë një goditje tjetër nga Novara. Zikaltërit ka probleme të mëdha në mbrojtje dhe përpara nuk po arrijnë të shënojnë. Historia kishite nisur për Ranierin, i cili ka arritur që të ngrejë skuadrën me 12 pozicione në klasifikim. Ndërkohë që me Gasperinin, skuadra nuk kishte fituar asnjëherë dhe ndodhej në zonën për të rënë nga kategoria. Tani Interi është në vendin e pestë dhe është gjashtë pikë nga zona e Champions League. Ky është objektivi minimal i skuadrës së Interit. Edhe pse ata kanë bërë shtatë fitore radhazi në kampionat, dhe ëndrra për titull u bë realitet, zikaltërit tashmë nuk kanë më shpresa për të fituar. Interi nuk po "ngren më kokën lart". Dhe numrat janë kundër saj. Nëntë janë humbjet sezonale, një rekord për javën e 23 të kampionatit. Shumë për të fituar një kampionat. Nëntë janë pikët që zikaltërit kanë

Merkato e dobët, vjetërsia e lojtarëve, mungesë motivimi dhe paaftësia: kështu ish-skuadra e "tripletës" është drejt zhdukjes



lënë me skuadrat që janë në zonën e rënies në klasifikim, gjashtë kundër Novarës dhe tre kundër Leçes. Tre janë humbjet në fazën e dytë. Dhjetë janë golat e pësuar nga Interit në katër ndeshjet e fundit. Por dhjetë janë vitet që Morati nuk ka luajtur në Championsin e fundit. Ishte kampionati 2000-'01, Lipi në fillim dhe Tardeli më pas e klasifikuan Interin në vendin e pestë. Ky është një eksperiment që nuk duhet provuar sërish. Edhe sulmi nuk qesh, 34 gola. Përveç Militos, i cili ka shënuar 12 gola, të tjerët janë zhdukur.

Kontestimet-Tifozyt zikaltër nuk janë aspak të lumtur me situatën që po kalon skuadra e Interit. Për këtë arsye nuk kanë munguar edhe kontestimet e ndryshme nëpër forume interneti por edhe përpara zyrave të Interit. "Turp, game over!" është një parullë që tifozyt kishin në duart e tyre.

Përgjigjia - Ndërkohe motra e Masimo Moratit, Bedi Morati nuk ka duruar dhe është përgjigjur në Tëit-ter. "Turp", nuk është një fjalë që i përket Interit. Turp për të pandershmit, hajdutët dhe mashtruesit, jo për ne. Forca Inter!".

9
janë humbjet e deritanishme në kampionat të zikaltërve

30
gola ka pësuar skuadra e Ranierit në 23 ndeshje të zhvilluara

Blank, në "pole" për stolin
Në këtë periudhë shumë të keqe të Interit, nuk mund të mungojnë spekulimet për pozicionin e trajnerit. Tashmë, emri i parë në listë duket se është ai i kombëtares franceze, Lorent Blank. Ish trajneri i Bordosë, nuk ka ndërmend të vazhdojë aventurën e tij në drejtimin e skuadrës së gjelave dhe në qershor mund të lirohet nga detyra e tij. "Euro 2012", do të jetë detyra e tij e fundit me kombëtaren franceze.

Juventus Higuain, Lavecì, ose Nani; ëndrrat "bardhezi" për të formuar një ekip Champions

Juventus është kthyer në nivelet e dikurshme dhe për këtë arsye ka nevojë për një merkato të denjë dhe të mirë. Objektivat janë për t'u përmirësuar ende. Kështu që "syte" janë hedhur në merkato. Atyre i duhen dy bombera dhe njëri prej tyre mund të jetë Higuain. Marrota ka nisur punën. Në dispozicionin e tij do të ketë edhe një fond shtesë, i cili vjen nga kualifikimi për në Champions League. Ndërkohë që nuk mund të harrohen edhe përfitimet nga stadiumi i ri. Nga të gjithë këto, duhet të merret një sulmues i nivelit të lartë, i cili mund të bëjë diferencën ndaj kundërshtarëve. Ashtu siç thamë emri i parë është ai i Higuain. Ai është i ri, shumë i fortë, por tek Reali nuk është titullar, dhe jo i pashitshëm. Emri i dytë është ai i Lavecit. Nuk është një bomber i jashtëzakonshëm, por është një element që do të funksiononte shumë mirë me skemat e Kontes. Ndërkohë që emri i tretë është ai i Nani, edhe pse kushton shumë. Ferguson nuk ka ndërmend që të lërë të lirë për një çmim të lirë.

"Task Force" në Parma për të pastruar dëborën!
Parashikimet për ditën e mërkurë janë të mirë, por problemi i vërtetë për ndeshjen Parma-Juventus, vjen nga stadiumi "Tardini", i cili është mbushur nga dëbora. Për këtë arsye klubi emilian ka ngritur një grup "Task Force" për të pastruar impiantin dhe për të hequr borën e rënë në ditët e kaluara. Ata do të kenë në dispozicion edhe dy ditë, deri të mërkurën në drekë. Gjithsesi, do të ketë një mbledhje tjetër sot në darkë, për të vendosur nëse ndeshje do të luhet, apo jo. Por ajo që bie në sy, është se kjo sfidë rrezikon të shtyhet sërish për shkak të borës së madhe të rënë në ditët e kaluara.

Dje				
Napoli-Kievo	2-0	Lacio-Çezena	3-2	
Britos 15', Kavani 28' (p)		Kaljari-Palermo	2-1	
Siena-Roma	0-1	Inter-Novara	0-1	
Kalaio 51' (p)		Atalanta-Leçe	0-0	
Të luajtura		Katania-Xhenoa	4-0	
Udineze-Milan	1-2	Bolonja-Juventus	e shtyrë	
		Parma - Fiorentina	e shtyrë	
Renditja				
1.Milan	23	47	11.Fiorentina	21
2.Juventus	21	45	12.Katania	21
3.Lacio	23	42	13.Parma	21
4.Udineze	23	41	14.Kievo	23
5.Inter	23	36	15.Atalanta *	22
6.Roma	23	35	16.Siena	22
7.Napoli	23	34	17.Bolonja	21
8.Palermo	23	31	18.Leçe	23
9.Kaljari	23	30	19.Çezena	22
10.Xhenoa	22	30	20.Novara	23

(Atalanta e penalizuar me 6 pikë)

Kombëtarja axurre

Prandeli: Pas Italisë, dua të marr sërish një klub!

"Titulli? Mendoj se do të jetë një duel mes Milanit dhe Juventusit"

Çezare Prandeli ka folur për të ardhmen e tij, e cila pas aventurës si trajner i Kombëtares Italiane, do të jetë në një stol klubi. "Me kombëtaren italiane kam një kontratë edhe për dy vite të tjera, por kam një dëshirë për të stërvitur një klub", u shpreh Prandeli. "Kam në konsideratë një eksperiencë jashtë vendit, por ky nuk është momenti për të folur për të ardhmen. Jam i përqëndruar

tek Europiani. Dëshiroj që t'i përgatis pa asnjë shqetësim tjetër". Më pas ai vazhdoi: "Juventus më ka kërkuar disa vjet më parë, por jo kohët e fundit. Baloteli? Ai ka një potencial të jashtëzakonshëm, por varet gjithçka nga ai. Ajo që është e çuditshme është sepse një lojtar i tillë ka marrë 8 javë pezullim në këtë sezon. Rosi dhe Kasano? Do të mendohej që t'i rekupejoj deri në

momentin e fundit. Duhet disi e vështirë për Kananon dhe më e lehtë për Rosin. Por duhet të shikojmë, pres një lajm të mirë nga të dy. Racizmi? Shëmbulli i fundit është ai i Evrasë. Kur një trajneri i madh si Ferguson thotë deklarata të tilla, duhet t'i vlerësojmë ato. Përsa më përket, duhet të luftojmë gjithmonë kundër racizmit. Nuk duhet asnjë tolerancë. Largim i i Kapelos? Kur një trajner

si Kapelo ka fituar gjithçka dhe më shumë se të tjerët, nuk mund të largohet për para ashtu siç thonë disa. Ai meriton respekt. Nuk e di arsyen e largimin e tij, por mendoj se ka më shumë se shiriti i kapitenit për Terin. Nuk kam patur mundësinë për të folur me të. Titulli? Mendoj se do të jetë një sfidë midis Juves dhe Milanit deri në fund. Do të jetë një sfidë e jashtëzakonshme".

Pronari mund të shkarkojë trajnerin para ndeshjes ndaj Napolit në Champions

Çelsi: Abramoviç, gati "gijotina" për Vijas Boasin

Lajmi është i thjeshtë, madje të duket si diçka e lexuar që më parë: Pronari i Çelsit, Roman Abramoviç, mund të shkarkojë trajnerin Andre Vijas Boas, në prag të ndeshjes së Ligës së Kampionëve ndaj Napolit, ndërsa miliarderi rus është tejet i acaruar nga seria negative e rezultateve të skuadrës së tij nën drejtimin e portugezit. "Roman po mendohet nëse duhet ta shkarkojë trajnerin e tij para ndeshjes ndaj Napolit", shkruan "Daily Mail" dhe tabloidi raporton se shqetësimi më i madh i rusit është se AVB mund ta ketë humbur kontrollin dhe respektin në skuadër, sidomos tek lojtarët kryesorë.

Në udhëtimin me avion që nga Liverpooli për në Londër, pas humbjes 0-2 ndaj Evertonit, AVB u deklaroi lojtarëve me nervat në



qie se dita e diel nuk ishte më pushim, por do të bënin stërvitje. "Paraqituni në Cobham në orën 10:00", ishte urdhëri i tij. Burimet brenda Çelsit njoftuan se lojtarët ishin tepër të ner-

vozuar gjatë stërvitjes dhe se besonin që AVB do të shkarkohej shumë shpejt.

Duket se nuk ka mbetur shumë deri në aktin final në "Stamford Bridge", edhe pse serialë të tillë nuk ia

Renditjet e bluve të Abramoviçit

Viti	Premier	Champions	Ti.
2011	2	1/4	Ançeloti
2010	1	1/8	Ançeloti
2009	3	1/2	Hidink
2008	2	Finale	Grant
2007	2	1/2	Murinjo
2006	1	1/16	Murinjo
2005	1	1/2	Murinjo
2004	2	1/2	Ranieri

kanë dhënë dot Ligën e Kampionëve, ambiciozit Roman Abramoviç. "Duhet të paktën të sigurojmë një vend për në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm, - shprehet Vijas Boas, - synimi gjithnjë është vendi i parë, por tani ai vend nuk mund të arrihet. As i dyti". Çelsi është 17 pikë prapa Mançester Sinit, me 43 ndaj 60 pikëve të fituara nga skuadra e Mançinit.

"Gijotina" e Abramoviçit nisi me Klaudio Ranierin, ndërsa rusi bleu klubin më 2003 për 140 milionë sterlina, rekordi i blerjeve të një klubi në Angli deri në atë kohë. Ranieri erdhi në klub në 2001 duke arritur në finalen e Kupës së Anglisë në 2002 dhe duke siguruar Champions-in për 2002-2003. Arritjet e romanit nuk ishin aq impresionuese, pasi Xhanluka Viali pati fituar më 1998 Kupën e Ligës

Karuseli: Të gjithë trajnerët e Romanit të Siberisë

dhe Kupën e Kupave të Europës dhe më 2000, Kupën e Anglisë. Zhoze Murinjo zëvendësoi italianin në 2004 dhe fitoi dy tituj në 2005 e 2006, fitoi Kupën e Anglisë në 2007 dhe Kupën e Ligës më 2005 dhe 2007, por u eliminua dy herë në gjysmëfinalen e Ligës së Kampi-

onëve. Avram Grant arriti në finalen e Champions-it në 2008, pasi zëvendësoi Murinjon në vjeshtë në 2007-ës. Në 2008, në krye erdhi Skolari, por që u largua shumë shpejt, ndërsa në pranverë të 2009-ës trajneri bë Gus Hidink. Holandezi fitoi Kupën e Anglisë dhe u

eliminua me pa të drejtë nga Barcelona në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve. Ai iku dhe Karlo Ançeloti fitoi titullin dhe Kupën në 2010, por doli i dyti në 2011, ndërsa u eliminua në 1/8 e finaleve të Champions-it. Vijas Boas është në një pozicion edhe më të keq, duke qenë i 5-ti në kampionat, i eliminuar nga dy kupa e Anglisë, por ende në lojë në Champions. Ky është shansi i tij i fundit.

Ai iku për shkak të Xhon Territ. Këto janë fjalët e Klod Makeleles në autobiografinë e tij botuar në 2009. Ishte kapiteni, shkak-tari për shkarkimin e Zhozesë. Përse? Pasi Murinjo i tha kapitenit se duhet të bënte disa ndeshje pushim në vjeshtë të 2007-ës, për shkak të problemeve fizike në shpinë.

Terri u përgjigj ballë-hapur se nuk kishte asnjë problem, por "Mou" mbylli diskutimin se në qendër të mbrojtjes do të luanin Karvaljo dhe Aleks. "Murinjo e dinte se tek Çelsi kishte vetëm një "të paprekshëm" dhe ky ishte Xhoni, por sërish ai e bëri atë veprim, shkruan Makelele, - përse? Ndoshta sepse donte të gjente një mënyrë për t'u



larguar pas konflikteve me Abramoviçin për blerjet e Shevçenkos dhe Balakut".

"Unë e mora vesh nga Didier Drogba, i cili më tha se "ai do të shkarkohet

nesër", - vazhdon ish-mbrojtës francez, - u habita, pasi e mendoja Zhozenë të paprekshëm". Të nesërmen, shkruan Makelele, kishte shumë kaos në stërvitje.

"Best seller"/ Si u largua Zhoze Murinjo nga "Stamford Bridge"

Gazetarë, fotoreporterë, madje edhe helikopterë që fluturonin mbi kokat tona. Fizioterapist portugez, Rui Faria, ma pohoi, "Klod, zërat janë të vërtetë, trajneri është shkarkuar".

"Bomba" u aktivizua pasi Terri shkoi tek shefi ekzekutiv i klubit, Piter Kenion, i shprehu pakënaqësinë dhe i kërkoi që të shkante në një klub tjetër. Kjo ishte pika ku Abramoviç nuk mund të duronte. Kapiteni ishte "i shenjtë" për tifozët dhe lojtarët. "Murinjo, duhet të bësh gati valixhet", ishte fjala e fundit e pronarit.

Siti

Tevez: Paqe me Mançinin? Më trajtoi si qen!

Pas 3 muajsh e gjysmë u duk se gjithëkoka përfundoi dhe koha shëroi plagët e thella. Por, Karlos Tevez nuk është nga ata që tërhiqen nga e vetja, edhe kur duket se kanë falur. Ndërsa sulmuesi argjentinas është në rrugën e tij të kthimit për në "Etihad" (ku do të paraqitet sot) dhe Roberto Mançini ia ka hapur një derë që të luftojnë që të dy për titullin kampion, Karlito nuk e ka lënë pa sulmuar trajnerin e tij. Madje ashpër. "Ai më trajtoi si të isha një qen gjatë konfliktit që patëm në shtator, - janë fjalët e Tevezit, - ai foli dhe u soll në mënyrë të gabuar, më shau, ndërsa unë qëndroja në stol në ndeshjen ndaj Bajernit në Champions". Ish-kapiteni foli për televizionin amerikan "Fox", duke shpjeguar se u nervozua shumë nga zëvendësimi i Xhekos me De Jongun në Mynih, ndërsa Siti po humbiste 0-2. "Ishte një zëvendësim mbrojtës dhe unë u ula në stol i nervozuar, - tha ai, - unë po bëja nxemje për 10 minuta dhe ai po përpiqej të humbiste 0-2 dhe jo 0-4".

"U bë një lëmsh i vërtetë kur Xheko u ul në stol, ndërsa ishte nervozuar me Mançinin, - vazhdoi Tevez, - Xheko po fliste në gjuhën boshnjake, Mançini shante në italisht. Më pas, më foli me ton të keq që të vazhdoja nxemjen dhe unë iu përgjigja i acaruar se nuk kisha ndërmend. Unë isha i qetë, ndërsa ai nisi të shante, duke thënë gjëra të tmerrshme".

S'ka falje - Roberto Mançini, pas fitores 1-0 ndaj Aston Vilës, u shpreh se Tevez mund të rikthehej në skuadër, por ai priste një falje prej tij. "Tevez do të kërkonte falje nëse do të kishte bërë gabime, por ai mendon se nuk ka bërë gabime", u shpreh agjenti i tij, Jorabçian.

Çështja "Suarez"

Janë milionat që detyruan Liverpul të kërkojë falje

Keni Dalglishit u deshën 120 ditë që të arrinte të kërkonte për herë të parë falje për sjelljen e Luis Suarezit. Blerja e tij uruguayane kishte kafshuar dikë në vesh në Holandë, duke u dënuar në mënyrë shembullore, pastaj shau në mënyrë raciste Evranë dhe u tregoi gishtin e mesit tifozëve të Fulhamit. Së fundi, nuk i dha dorën Evrasë, i cili duket se e kishte falur.

Gjithë ky procesion çmendurie, në të cilin trajneri e kishte mbrojtur lojtarin e tij mori fund pasi Liverpooli bëri presion ndaj tyre, i detyruar nga një trysni e madhe ndërkombëtare. Pronari Xhon Henri u deklaroi protagonistëve të tij fatkeqë se "klubi është më i rëndësishëm sesa lojtari apo trajneri". Vetë pronari amerikan pati presion nga sponsorët e rëndësishëm që i japin klubit të "Anfield"-it, 20 milionë sterlina në sezon. Pra, jo gjithnjë interesi i parave mund të jetë "i pistë".

PREMIER LEAGUE/Java XXV

Të shtunën		Sandërlend-Arsenal	1-2
Mançester J.-Liverpool	2-1	Suonsi-Noruç	2-3
Blekbëm-QPR	3-2	Tottenham-Njukasëll	5-0
Bolton-Uigan	1-2	Të dielën	
Everton-Çelsi	2-0	Uolves-Uest Brom	1-5
Fulham-Stouk Siti	2-1	Aston Vila-Mançester S.	0-1

Renditja

	N	F	B	H	Gola	P
1.Mançester S.	25	19	3	3	64-19	60
2.Mançester J.	25	18	4	3	61-25	58
3.Tottenham	25	16	5	4	49-25	53
4.Arsenal	25	13	4	8	48-35	43
5.Çelsi	25	12	7	6	44-31	43
6.Njukasëll	25	12	6	7	36-36	42
7.Liverpul	25	10	9	6	29-23	39
8.Noruç	25	9	8	8	37-41	35
9.Sandërlend	25	9	6	10	34-26	33
10.Everton	25	9	6	10	26-27	33
11.Suonsi	25	7	9	9	28-32	30
12.Fulham	25	7	9	9	31-36	30
13.Stouk Siti	25	8	6	11	24-38	30
14.Uest Brom	25	8	5	12	29-35	29
15.Aston Vila	25	6	10	9	29-34	28
16.QPR	25	5	6	14	27-44	21
17.Blekbëm	25	5	6	14	37-56	21
18.Uolves	25	5	6	14	28-49	21
19.Bolton	25	6	2	17	29-51	20
20.Uigan	25	4	7	14	23-50	19

Kupa e Afrikës/ Vetëm 3 futbollistë luajnë jashtë vendit të tyre

Mrekullia Zambia; ja se si minatorët mundën milionerët

Shumica e lojtarëve të Renard punonin në minierat e bronxit dhe paguheshin vetëm 10 euro në muaj

Kundër çdo parashikimi, skuadra e Zambias, që ndryshe quhen edhe "Çipolopolo" arriti të mundte në finale të Kupës së Afrikës Bregun e Fildishtë të Didier Drogbasë. Një fitore, që, për të gjithë, është dukur sikur ka qenë e shkruar në fatin e kësaj kombëtareje.

Ngjarja—Përtej ndeshjeve, apo surprizave në kampionatet europiane, lajmi më i rëndësishëm i ditës së dielë nuk ka qenë humbja e Interit ndaj Novarës. Kjo, sepse pak më poshtë në hartë, larg syrit zmadhues dhe emergjencës së dëborës që ka pushtuar Europën, është një vend i vogël dhe i varfër që sapo është shpallur Kampion i Kupës së Afrikës, për herë të parë në historinë e tij, me një skuadër, thuhet të panjohurish. Kundër të gjitha parashikimeve, Za-



Renard mban në krahë lojtarin e dëmtuar

Pak momente pasi kishin fituar Kupën e Afrikës, lojtarët e Zambias janë mbledhur për një festë pranë njërit prej flamurëve të këndit. Të gjithë, përveç njërit. Mbrojtësit, Xhosef Musonda, i cili ishte dëmtuar në 45' e para dhe s'mund të vraponte. Dhe, Musonda rrezikonte të humbiste momentin më të bukur. Në atë moment, trajneri i Zambias, francezi Renard ka marrë në krahë lojtarin e dëmtuar dhe ka vrapuar në drejtim të turmës së lojtarëve, duke e çuar atë tek riti pas fitores. Një gjest ky solemn dhe shumë i vlerësuar nga të gjithë, që kanë duartrokitur.

mbia ka mundur në finale Bregun e Fildishtë të Drogbasë dhe të vëllezërve Ture, 8-7, përmes penalltive. Me një gabim deçiziv, pikërisht të bërë nga Drogba.

Ishte fati—Finalja është luajtur sipas programit, në Libervil, atje ku në prillin e vitit 1993, ka rënë edhe aeroplani i Kombëtares së Çipolopolo-ve, i cili ka vrarë një gjeneratë të tërë futbollistësh zambian. Zambia ishte në tentativën e tretë, pas dy vendeve të dyta, ku ka humbur dy herë në finale të 1974 dhe në 1994.

Një skuadër minatorësh—Vetëm dy lojtarë nga Kombëtarja e Zambias luajnë jashtë. Njëri nga ata është sulmuesi Majuka, 22 vjeç, në Zvicër dhe mesfushori Lungu, 21 vjeç, që luan në Gjeorgji. Në përfaqësuese ka lojtarë që kanë punuar në minierat e bronxit, që menaxhohen nga kinezët, për një pagesë prej 10 euro në muaj. Njëri nga ata është Sunzu, i dalë nga miniera e Çingolas, që luan me Mazemben, skuadrën kongoleze që doli në finale me Interin. Dhe, më pas është Lungu, i arratisur dhe i përfunduar si klandestin 300 kilometra nga Tbilisi. Apo Kangua, sapo ka mbushur 17 vjeç dhe ka punuar në Katua dhe që trajneri Renard e ka grumbulluar, pasi e ka parë të luante me amatorët. Ka qenë pikërisht kjo Zambia që ka fituar Kupën e Afrikës, ndaj milionerëve të Bregut.

Primera Division

Ironia e Murinjos: Të marrësh trofeun mjafton edhe një 1-0

Portugezi "thumbon" rivalët e Barçës: "Nëse në "Bernabeu" do ta preknim topin aq shumë, do të na fërshëllenin"

Hoze Murinjo nuk ka ngurrar të shprehë hapur admirimin e tij për Kristiano Ronaldon pas takimit të fituar 4-2 ndaj Levantes. Sulmuesi shënoi një tregolësh në këtë sfidë për të shkëputur ekipin e tij 10 pikë nga Barcelona, por Murinjo ka mbetur i mahnitur nga mënyra e shënimit të golit të tretë të lojtarit portugez. "Goli i Kristiano Ronaldos ishte i pabesueshëm, fantastik dhe besoj se do të bëjë xhiron e botës gjatë javëve të ardhshme. Kjo është ajo që mendon e gjithë skuadra. Ishte goli i 4000-të i shënuar në "Santiago Bernabeu" dhe ai e meritonte plotësisht", deklaroi trajneri i cili ka festuar me bashkëkombësin e tij në momentin e shënimit të këtij goli. Vetë futbollisti ka preferuar që t'ia dedikojë suksesin skuadrës. Në fund, Hoze Murinjo ka ironizuar edhe me kundërshtarët, pra Barcelonën: "Më pëlqen të fitoj ndeshjet 1-0 dhe jo 8-0, sepse është e njëjta gjë. Në fund, rëndësi kanë pikët dhe jo golat. Nëse ne në "Bernabeu" e prekim topin qindra herë dhe e pasojmë, do të na fërshëllenin".

Pepe: S'jam vrasës, fajin e ka shtypi!

Mbrojtësi i Real Madridit, Pepe, ka shprehur zemërimin e tij me mënyrën se si ai është trajtuar nga media dhe ka krahasuar portretizimin e tij në shtyp me atë të një vrasësi. Pepe ka folur rreth kritikës për stilin e tij të lojës agresive, në veçanti kur "Los Blancos" përballen me rivalët e hidhur Barcelonën dhe 28-vjeçari mendon se gazetarët e Spanjës kanë qenë shumë të ashpër ndaj tij. "Shtypi më ka portretizuar mua si një vrasës", ka thënë Pepe në një intervistë për "Canal +". "Për mua gjëja më e rëndësishme është që të mbroj ngjyrat e Madridit". Mbrojtësi pastaj vazhdoi duke diskutuar të ardhmen e trajnerit Hoze Murinjo, i cili ka qenë i lidhur me një largim nga "Santiago Bernabeu". Ai deklaroi se lojtarët janë të bindur se trajneri i tyre nuk shkon askund. "Trajneri ka një kontratë të vazhdueshme dhe është pjesë e Madridit, ashtu si lojtarët. Ne jemi të bindur se ai do të mbetet trajner këtu", deklaroi portugezi.

Grushte në stërvitje,

Sevilja pezullon 2 lojtarë

Trajneri Mishel e ka nisur me probleme aventurën e tij te Sevilja. Ende pa debutuar në stolin e skuadrës, ai është detyruar të përjashtojë dy lojtarë. Gjatë stërvitjes së djeshme, një ditë para ndeshjes në transfertë kundër Real Sociedad, Medel e Spahiq janë zënë me njëritjetrin, aq sa nuk i kanë kursyer edhe grushtet. Është dashur ndërhyrja e pjesës tjetër të ekipit për t'i ndarë, ndërkohë që tekniku Mishel u ka kërkuar të dyve që të largohen nga kompleksi stërvitor. Ndërkohë për fatin e tyre do vendosin drejtuesit e klubit.

Bekenbauer "sulmon" Robenin: Është egoist!

Sikur të mos mjaftonin kalvari i problemeve me dëmtimet, rendimentin, apo dhe spekulimet për të ardhmen Arjen Roben ka një kritikë më shumë, madje një emër me peshë siç është Franc Bekenbauer. Ish-futbollisti i Kombëtares Gjermane e akuzon sulmuesin holandez se është shumë egoist. 66-vjeçari mendon se Roben duhet të jetë më shumë mirënjohës ndaj shokëve të tij të skuadrës kur shënon, në vend që të shikojë në shkallët e stadiumit për të festuar me familjen e tij. "Roben është një lojtar egoist, si shumë të tjerë. Reagimi i tij pas një aksioni të mirë apo një goli e tregon këtë. Ai nuk falenderon personin që i jep asistin, por vrapon drejt shkallëve të stadiumit për të

kërkuar familjen e tij. Në këtë mënyrë skuadrës i duhet që të vrapojë pas tij. Në këtë mënyrë do të vijë një moment kur shokët e tij të skuadrës, do të mendojnë: Nëse unë të jap topin dhe ti nuk ndihesh mirënjohës për këtë, atëherë herën tjetër hajde e merre vetë. Ai duhet të mendojë më shumë për skuadrën". Deklarata e Bekenbauerit vjen pas asaj të Franc Riberisë i cili shprehu opinionin se Tomas Myler luan më mirë në krahun e djathtë, atje ku është pozicioni natyral i Robenit. Holandezi ka shënuar 5 gola në 12 ndeshje në të cilat është aktivizuar në këtë sezon të Bundesligës, por nuk ka patur vijimësinë e duhur në skuadër për shkak të dëmtimeve.

klubi i Anzhit. Por, shkarkimi bën më të fortë zërat, sipas të cilëve, Anzhi po kërkon që të sjellë Fabio Kapelon. Trajneri italian, prej pak kohësh, është larguar nga stoli i Anglisë, teksa është mësuar se ai ka qenë në Moskë dhe madje është rikthyer në Sent Morris me avionin privat të Kerimov. Por, Kapelo nuk e ka pranuar një gjë të tillë. Ndërkohë, nga sa mësohet, duket se ka qenë Eto'o dhe agjenti i tij që po merren me sjelljen e Kapelos në Rusi.

Ikën Krasnozhan, Anzhi përgatitet për... Kapelon

Anzhi Makaçkala ka shkarkuar trajnerin Juri Krasnozhan, i cili nuk kishte më shumë se një muaj që ishte në detyrë. Një lajm të tillë e ka bërë publik klubi i miliardërit dagestanez, Sulejman Kerimov. "Palët kanë arritur në një akord për të mos publikuar arsyet e kësaj ndarjeje", pranon

Van Basten, trajneri i ri i Herenvenit

Legjenda holandeze, Marko van Basten, do të marrë drejtimin e Herenvenit në fund të sezonit aktual. Trajneri i tanishëm, Ron Jans, ka deklaruar se do të tërhiqet nga ky post porsa t'i skadojë kontrata, ndërsa gazeta "Voetbal International" njofton se ish-sulmuesi i Milanit do ta marrë drejtimin e klubit holandez. Caktimi i Van Bastenit ka ardhur si befasi, pasi është pritur që trajneri i FC Cvoles, Art Langeler, të angazhohet si trajner i Herenvenit, ndërsa është përmendur edhe emri i ish-trajnerit të Holandës dhe Bajernit të Mynihut, Luis Van Gal.



PRIMERA DIVISION/ Java XXIII

Mbrëmë	Valencia-Gijon	4-0
R.Sociedad-Sevilja	Vilareal-Granada	3-1
Të luajtura	Real M.-Levante	4-2
Espanjol-Saragoza	Santander-Atletiko M.	0-0
Malaga-Majorka	Osasuna-Barcelona	3-2
R.Vajekano-Getafe	Betis-A.Bilbao	2-1

	Renditja					
	N	F	B	H	Gola	P
1.Real Madrid	22	19	1	2	75-21	58
2.Barcelona	22	14	6	2	63-16	48
3.Valencia	22	11	7	4	35-22	40
4.Levante	22	9	5	8	29-29	32
5.Espanjol	22	9	5	8	25-26	32
6.Atlético M.	22	8	7	7	31-27	31
7.Malaga	22	9	4	9	28-32	31
8.Osasuna	22	7	10	5	26-35	31
9.A.Bilbao	22	7	9	6	34-30	30
10.R.Vajekano	22	8	4	10	27-32	28
11.R.Sociedad	22	7	6	9	25-30	27
12.Getafe	22	7	6	9	22-29	27
13.Sevilja	22	6	8	8	22-26	26
14.Betis	22	8	2	12	25-31	26
15.Vilareal	22	6	8	8	23-30	26
16.Majorka	22	6	7	9	19-28	25
17.Granada	22	7	4	11	17-31	25
18.Santander	22	4	11	7	18-26	23
19.Gijon	22	5	4	13	20-43	19
20.Saragoza	22	3	6	13	18-38	15



Lule, çokollata
apo parfum?

**PARA
NË ÇAST***

Gëzuar Shën
Valentinin!



UNIONI FINANCIAR TIRANE
Agjenti i Western Union, Shqipëri

☎800 44 55
+ 355 4 2 234 979

www.unionifinanciar.al

**WESTERN
UNION**

moving money for better

* Subjekt i orareve të shërbimit dhe ndryshimeve në orët lokale.